

UDHËZIM
Nr.16, datë 3.5.2010

PËR ADMINISTRIMIN DHE DOKUMENTIMIN E PROCEDURAVE TË PAJISJEVE FISKALE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të neneve 55 dhe 56 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. PAJISJET FISKALE, SISTEMET FISKALE, FORMA DHE FUNKSIONI

Pajisja fiskale dhe sistemi fiskal (të përdorur në sektorë specifikë) janë pajisje në të cilat regjistrohen të dhënat për vlerën e mallrave të shitura dhe shërbimeve të kryera për klientët, duke siguruar në këtë mënyrë gjenerimin e raporteve të veçanta.

Pajisja fiskale ka si qëllim të regjistrojë dhe të transmetojë të dhënat në sistemin e integruar kompjuterik.

Të dhënat duhet të regjistrohen në mënyrë të njëkohshme në një njësi memorie operative dhe qarkun e shiritit të kontrollit elektronik, si dhe të printohen në kupon tatimor.

Totali e të dhënave të ruajtura në memorien operative të një dite të ruhen në memorien fiskale pas mbylljes së raportit tatimor ditë dhe dërgohen në sistemin e integruar kompjuterik në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve përmes rrjetit GPRS me një protokoll komunikimi të veçantë dhe në formë të koduar (encriptuar). Enkriptimi do të bëhet nga një modul (krypto-chip) i tipit “Secure Microcontroller”, i cili nuk duhet të jetë pjesë përbërëse e memories fiskale apo QSHKE apo kartës SIM.

Mbyllja e raportit tatimor ditë shoqërohet me një kupon të printuar dhe ruhet si një dokument tatimor nga tatimpaguesit.

1.1 Programi i logjikës (firmware)

Pajisja fiskale ka një program logjik (Firmware) në gjuhën shqipe, i cili ndërtohet ekskluzivisht sipas kërkesave të këtij udhëzimi, i mbrojtur nga ndryshimi dhe fshirja pa hapur pajisjen fiskale, duke përdorur funksionet standarde për regjistrimin e shifrave të mallrave e shërbimeve, printimin, paraqitjen dhe administrimin e të dhënave, të hyra në memorie fiskale, përfshirë dhe mënyrat e pagesave relative (para në dorë (cash), kartë krediti, çek bankar etj.). Lëshon kuponë përmbledhës për këto veprime, raportet tatimore ditore të lidhura reciprokisht me transmetimin e raporteve tatimore periodike. Programi logjik duhet të jetë i ndërtuar në mënyrë që pajisja fiskale të veprojë në pesë regjime: regjistrim (R), lexim (X), mbyllje (Z), programim (P), si dhe regjimi i trajnimit (T).

1.1.1 REGJIMI I REGJISTRIMIT (R):

a) siguron regjistrimin e qarkullimit dhe e printon atë mbi një letër shirit që i jepet klientit (këtu më poshtë e referuar si kupon tatimor). Ky regjistrim kryhet në mënyrë progresive për të gjithë kuponët e lëshuar që vërtetojnë shitjet. Në fund të çdo kuponi tatimor printohet numri i identifikimit të pajisjes fiskale dhe logo fiskale e detyrueshme;

b) siguron regjistrimin e vlerës reale të mallrave, dhe/ose shërbimeve, nëpërmjet rrumbullakimit deri në dy numra dhjetorë;

c) siguron regjistrimin në memorien operative dhe QSHKE, bashkon dhe përmbledh të dhënat relative me kuponët e mëparshëm, në memorien operative. Të dhënat nuk mund të jenë më të vjetra se data e prezantimit të pajisjes fiskale, dhe të dhënat më të reja të futura nuk mund të jenë më të vjetra se data, për të cilën është përgatitur raporti periodik;

d) siguron ruajtjen e të dhënave të regjistruara në memorien operative dhe regjistrimin e tyre në shiritin e kontrollit elektronik.

1.1.2 REGJIMI I LEXIMIT (X)

Siguron leximin dhe printimin e të dhënave të regjistruara në memorien fiskale.

a) siguron leximin statistikor të qarkullimit ditore të regjistruar dhe e paraqit atë në formë të ndryshme raporti përmbledhës apo të detajuar;

b) siguron leximin statistikor të qarkullimit, në përputhje me njësitë e standardeve kohore ditë, muaj dhe vit;

c) të gjitha raportet e printuara në këtë pozicion kanë efekte statistikore jotatimore. Në kokën e çdo raporti në këtë pozicion duhet të shënohet emri i tipit të raportit dhe sigla e regjimit të leximit (X), dhe të printuar në fillim dhe në fund të kuponit sigla në bold “RAPORT JOTATIMOR”. Këta kuponë regjistrohen në numërorin progresiv të kuponëve jotatimorë dhe detyrimisht duhet të regjistrohen në qarkun e shiritit të kontrollit elektronik.

1.1.3 REGJIMI I MBYLLJES (Z)

Në këtë regjim mund të:

a) Kryhet mbyllja e qarkullimit ditor, krahason të dhënat e ruajtura në memorien operative me të dhënat e ruajtura në QSHKE. Pas konfirmimit për saktësi ruan totalët ditore në memorien fiskale. Dërgon të dhënat në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në sistemin e integruar kompjuterik dhe printon raportin tatimor ditor duke pasqyruar në fund të kuponit rezultatin e transmetimit.

b) Kryhet transmetimi i raporteve tatimore periodike.

c) Kryhet transmetimi i të dhënave duhet të bëhet menjëherë pas mbylljes së raportit tatimor ditor në mënyrë automatike. Në rast se transmetimi nuk realizohet, raporti tatimor ditor të ruhet si i patransmetuar për t’u transmetuar gjatë mbylljes së raportit tatimor ditor pasardhës. Koha maksimale e ruajtjes së raporteve ditore të patransmetuara është 10 raporte, pas së cilës pajisja fiskale bllokohet se regjistruari.

d) Sigurohet leximi i memories fiskale në përputhje me njësitë e standardeve kohore ditë, muaj dhe vit mbi fluksin e shitjeve dhe analizat statistikore për aktivitetin tregtar.

e) Sigurohen kushte për kryerjen e provës përmes logos fiskale që printohet në çdo raport tatimor ditor për arsye të kontrollit të saktësisë së pajisjes fiskale, të memories fiskale dhe qarkut të shiritit të kontrollit elektronik, si dhe të funksionit në lidhje me të. Raportet tatimore-ditore apo karakterizohen nga titulli i raportit i shoqëruar nga sigla (Z) dhe në fund të kuponit printohet logo fiskale dhe sigla në bold “RAPORT TATIMOR”.

f) Sigurohet transmetim të dhënash manuale nëse këto të fundit nuk janë transmetuar për 10 raporte me radhë nga e cila pajisja fiskale është e bllokuar, si dhe transmetimin manual të të dhënave në periudha.

1.1.4 REGJIMI I PROGRAMIMIT (P)

Në këtë regjim në pajisjen fiskale mund të:

a) Regjistrohen të dhënat e tatimpaguesit, të cilat duhen të shfaqen në kuponin tatimor. Për këtë funksion programi logjik duhet të regjistrojë në memorien fiskale numrin e identifikimit të tatimpaguesit, emri, adresa ku është instaluar pajisja fiskale, numri i identifikimit të pajisjes, numri i identifikimit të transmetuesit të të dhënave (IMEI), numri i identifikimit të kartës SIM (IMSI), çelësi RSA publik apo çelësi simetrik pasi të ketë kryer procedurën e inicializimit. Ndalon regjistrimin në reshta të rinj të adresës apo IMEI apo IMSI apo çelësive në rastet kur ka ndryshime, pa kryer fillimisht raportin tatimor ditor dhe dërgimin e të dhënave në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

b) Të programojë shkallët tatimore. Ky funksion është i mundur në momentin e instalimit ose vetëm pasi të jetë kryer mbyllja e raportit tatimor ditor dhe kryen paraqitjen e hollësishme të shkallëve tatimore, të shënuara me germa A-I, shkalla e taksës. Me A nënkuptohet shkalla tatimore e përjashtuar, me B shkalla tatimore 20%, ndërsa me germa C-I format e ndryshme të shkallës tatimore të parashikuar me ligj. Për tatimpaguesit që nuk kanë detyrim pagese të TVSH shkalla tatimore për TVSH në kuponë do të përdoret ajo me 0 (germa C), por jo e përjashtuara. Ndryshimi i një shkalle tatimore mund të kryhet vetëm pasi kryhet raporti tatimor ditor dhe ndryshimet e bëra regjistrohen në memorien fiskale dhe në qarkun e shiritit të kontrollit elektronik me një numëratore të veçantë për ndryshimet e shkallës tatimore.

c) Të administrojë:

- Artikujt:

- kodi i artikullit;

- emërtimet e mallrave apo shërbimeve;

- çmimi 1, çmimi 2, çmimi 3;

- Uljet;

- Mënyrat e pagesës;

- administron grafikët (logon e tatimpaguesit për ta vendosur në kuponin tatimor);

- administron portat seriale të pajisjes fiskale për programimin e tyre për t'u lidhur me pajisje shtesë, të tilla, si: bar-kod, skaner, peshore, terminal për pagesën nëpërmjet kartave të kreditit etj.

d) Të programojë parametrat e komunikimit me rrjetin e komunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për transmetimin e raporteve tatimore periodike.

e) Programimi i datës dhe orës. Programi logjik ndalon ndryshimin e datës, nëse janë kryer regjistrime në memorien fiskale. Lejon programimin e orës legale brenda kufirit të vetëm +/- një orë, vetëm pasi kryhet mbyllja e raportit tatimor ditor.

f) Të kryejë kontrollin dhe leximin e memories fiskale dhe qarkut të shiritit të kontrollit elektronik.

1.1.5 REGJIMI I TRAJNIMIT (T)

Programi logjik (firmware) lejon procesin e trajnimit me të gjitha funksionet e pajisjes fiskale. Ky veprim është i mundur vetëm pasi është kryer raporti tatimor ditor dhe vetëm nëse pajisja është e fiskalizuar. Në këtë fazë gjithë hapësirat në kuponët e lëshuar duhet të mbushen nga simboli “?” dhe në kokën e kuponit siglën “INFO JOTATIMORE”.

1.2 Forma dhe paraqitja e pajisjes fiskale

Karkasa e pajisjes fiskale duhet të jetë vetëm me një pozicion për ta hapur atë. Në këtë pikë vendoset vula fiskale mbi të cilin shënohet me një goditës (puncon) që ka të sigluar shenjat e vulës së identifikimit të teknikut të autorizuar, lista e të cilëve është e depozituar nga shoqëritë e autorizuar me numrat përkatës të identifikimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Pajisja ka të ekspozuar në pamjen e dukshme të klientit, etiketën e identifikimit sipas formës së paraqitur më poshtë.

Shembull etikete identifikimi të pajisjes fiskale Fiskal

CE ROHS	Shoqëria e autorizuar	
	Modeli	
	Numri i identifikimit	
Tensioni 230 V	Numri i autorizimit MF	
	Numri i autorizimit KMF	
	Data e autorizimit KMF	

dhe etiketën e kontrollit periodik pozitiv me ngjyrë jeshile të paraqitur si më poshtë:

Regjistruesi Elektronik Fiskal		
Nr. □□ □□□□□□□□		
KONTROLLI PERIODIK SKADON		
MUAJI	VITI	MUAJI
1	Vula identifikuese e Teknikut	7
2		8
3		9
4		10
5		11
6		12

- Forma: katrore
 - Dimensiononi i brinjëve: > 40 mm
 - Ngjyra: fusha jeshile me germa të mëdha të zeza.
 - Poshtë shkrimit PAJISJA FISKALE shkruhet numri i identifikimit të pajisjes.
 - Në pozicionin e shënuar si _____ shkruhet viti i kontrollit periodik pasardhës.
 - Në eklips vendoset vula fiskale që identifikon shoqërinë dhe teknikun që është ngarkuar për kryerjen e kontrollit periodik.
 - Materiali: Adesiv që nuk lejon të hiqet dhe shkatërrohet me provën për ta hequr.
- Në rastet kur pajisja fiskale nuk e ka kaluar kontrollin periodik (apo është refuzuar) në pamjen e dukshme të publikut, tekniku i autorizuar duhet vendosë etiketën e kontrollit periodik negativ të paraqitur si më poshtë:

Regjistruesi Elektronik Fiskal	
Nr. □□ □□□□□□□□	
NUK FUNKSIONON	
Vula identifikuese e Teknikut	

- Forma : katrore
- Dimensiononi i brinjëve: > 40 mm
- Ngjyra: fusha e kuqe me germa të mëdha të zeza, e vijëzuar nga një diagonale
- Germat : bold, lartësia 5 mm

- Poshtë shkrimit PAJISJA FISKALE shkruhet numri i identifikimit i pajisjes. Poshtë shkrimit NUK FUNKSIONON dhe në logotipin e paraprintuar nga laboratori vendoset vula fiskale që identifikon shoqërinë dhe teknikun që është ngarkuar për kryerjen e kontrollit periodik.

- Materiali: Adesiv që nuk lejon të hiqet dhe shkatërrohet me provën për ta hequr.

Pajisja fiskale është e shoqëruar gjithmonë me pasaportën teknike (mund të jetë në faqen e parë të librit të mirëmbajtjes) dhe librin e mirëmbajtjes. Në pasaportën teknike paraqiten të gjitha të dhënat e elementeve përbërëse të pajisjes fiskale. Në librin e mirëmbajtjes regjistrohen të gjitha veprimet e kryera me pajisjen fiskale. Në faqen e fundit të librit fiskal duhet të jetë e printuar dhe firmosur nga administratorët e shoqërive të autorizuar Deklarata e përputhjes teknike dhe funksionale të pajisjeve fiskale që këto shoqëri do të shesin me karakteristikat teknike dhe funksionale të modelit të autorizuar nga Komisioni i Ministrisë së Financave.

1.3 Të dhënat e ruajtura në QSHKE

Pajisja fiskale regjistron dhe certifikon shitjet dhe këtë e regjistron në të njëjtën kohë si në memorien operative edhe në shiritin e kontrollit i zbatuar në formë kujtese elektronike dhe emërtohet si qarku i shiritit të kontrollit elektronik ose shkurt QSHKE, i cili vërtetëson dhe nuk lejon ndryshimet e informacionit në memorien fiskale. Të dhënat e printuara mbi kuponin tatimor duhet të jenë identike me të dhënat mbi QSHKE.

Qarqet e shiritit të kontrollit duhet të kenë një etiketë sipër mbi të cilën shkruhet numri progresiv i tyre. Programi logjik i pajisjes fiskale duhet të sigurojë bllokimin e punës nëse hiqet qarku i shiritit të kontrollit elektronik, zëvendësohet me qarkun e ndonjë pajisje tjetër apo kur është i virgjër të mos lejojë regjistrimin e qarkullimit pa e inicializuar atë. Ky qark duhet të njihet vetëm nga pajisja fiskale mbi të cilin është kryer inicializimi fillestar i tij dhe pasi mbushet plot, ruhet dhe për së paku 5 (pesë) vjet nga tatimpaguesi. Në rast se një QSHKE zëvendësohet para se të jetë mbushur (në raste defekti apo jo), ajo nuk mund të përdoret më në të njëjtën pajisje për regjistrime shitjesh. Përdorimi i qarkut të mbushur kryhet vetëm për efekte kontrolli dhe statistikore. Tregimi i të dhënave mbi shiritin e kontrollit dhe në memorien fiskale nuk duhet të bëhet nëpërmjet përdorimit të shkurtimeve të kodifikuara.

Shembull i etiketës mbi QSHKE:

Numri progresiv i QSHKE të inicializuara
Modeli i pajisjes fiskale Fiskal
Numri identifikimit të pajisjes fiskale ku është vendosur
Data e fillimit dhe data e mbarimit të QSHKE

QSHKE Nr.	_____
Modeli i Kasës	_____
Numri i Identifikimit	_____
Data fillimit	_____
Data mbarimit	_____

Në rastet kur QSHKE është me përmasa më të vogla se etiketa e saj QSHKE duhet të vendoset në një kuti (kase) mbi të cilën vendoset etiketa, dhe mbi QSHKE vendoset një etiketë adezive me numrin progresiv të këtij qarku.

Shembull i etiketës mbi QSHKE:

Numri progresiv i QSHKE të inicializuar

Nr. _____

1.4 Memoria fiskale dhe të dhënat e ruajtura në të

Memoria fiskale nuk lejon ndryshime të regjistrimeve, por vetëm shkruajtjen e regjistrimeve të reja.

Në rastin kur subjektet ndryshojnë adresën, numri i identifikimit të transmetuesit të të dhënave (IMEI), numri i identifikimit të kartës sim (IMSI) këto të dhëna futen si regjistrime të reja (rresht i ri). Programi i logjikës duhet të jetë në gjendje të afishojë dhe të marrë në

konsideratë të dhënat më të reja të futura për këto elemente. Numri maksimal i regjistrimeve të reja për çdo element të përmendur me sipër është 20. Për çdo ndryshim të këtyre elementeve duhet të kryhet procedura e inicializimit e cila fillon pas aprovimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Shoqëria e autorizuar dërgon një kërkesë me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në raste ndryshime të këtyre elementeve (adresë, IMEI, IMSI) duke kërkuar edhe kodin e kontrollit. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgon në përgjigje kodin e kontrollit duke autorizuar këto ndryshime në sistemin e integruar. Shoqëria e autorizuar duhet të paraqesë në pajisje kodin e kontrollit gjatë inicializimit dhe duhet ta regjistrojë atë në librin e mirëmbajtjes.

2. Kuponi tatimor

2.1 Logo fiskale, forma

Logo fiskale është shenja identifikuese që vendoset në çdo kupon tatimor që certifikon dhe regjistron shitjet në memorien fiskale dhe në qarkun e shiritit të kontrollit. Logo fiskale vendoset në të gjitha raportet tatimore ditore.

Logo fiskale është e përbërë nga dy rreshta:

1. Në rreshtin e parë shkruhet RSH (Republika e Shqipërisë);
2. Në rreshtin e dytë shkruhet MF (Ministria e Financave).

Në lartësinë e dy rreshtave të logos përpara RSH dhe MF duhet të jetë stema e republikës në variantin bardhë e zi:

Forma grafike e logos fiskale:



1. Fjalët RSH dhe MF duhet të jenë:
2. Fonti – Arial;
3. Formati – Bold;
4. Madhësia e shkrimit e njëjtë me madhësinë e shkrimit të elementeve të tjera të;
5. Kuponit tatimor;
6. Lartësia e siglës së Republikës e barabartë me lartësinë e dy rreshtave të fjalëve

RSH

7. dhe MF

8. Logo fiskale vendoset në fund të kuponit i pozicionuar në qendër.

2.2 Të dhënat e kuponit tatimor dhe prezantimi grafik i tij

Kuponi tatimor që i jepet një blerësi apo një klienti, përmban të dhënat e mëposhtme:

2.2.1 Koka e kuponit:

- a) Emrin, adresën e tatimpaguesit;
- b) NIPT-in;

2.2.2 Detajet e kuponit tatimor:

c) Emrin, sasinë, çmimin dhe vlerën e qarkullimit të regjistruar të mallrave dhe/ose të shërbimeve;

- d) Totale e vlerës së mallrave apo shërbimeve të shitura;

e) Mënyrën e pagesës (cash, çek, kartë krediti etj.);

f) Shumën e TVSH-së, sipas shkallës tatimore;

2.2.3 Këmba e kuponit tatimor:

g) Numrin e identifikimit të pajisjes fiskale;

h) Numri i pajisjes (identifikon numrin në rrjet për një supermarket), emrin ose kodin e operatorit;

- i) Datën dhe orën e lëshimit të kuponit;

j) Logon fiskale;

k) Numrin e kuponit.

Kuponi tatimor mund të reklamohet edhe të dhëna të tjera. Të dhënat tatimore të printuara mbi kuponin tatimor duhet të jenë identike me të dhënat mbi qarkun e shiritit të kontrollit. Nuk është e detyruar të regjistrohen në QSHKE logo apo reklama të printuara mbi kuponin tatimor.

Prezantimi i kuponit tatimor në rast se pajisja fiskale është e lidhur me një kompjuter kur punon përmes një aplikacioni (software) ose në rastin kur përdoruesi kryen shitje me pajisjen fiskale duke përdorur kodet e artikujve përmes funksionit PLU (Price Look Up).

EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it logo grafike e tij			Koka e kuponit
	LEK		Identifikon valutën kombëtare
1 x 60,00			
UJË NATYRAL	60,00 B		
1x60,00			Përshkrimi i artikujve, sasia, çmimi për njësi dhe totale për artikull i shoqëruar nga germa që identifikon shkallën tatimore.
KAFE EKSPRES	60,00 C		
NENTOTALE	120,00		Totale parciale në pritje për mënyrat e pagesave ose valuta.
TOTALE LEKE	120,00		Totale në lekë
PARA NË DORË	200,00		Mënyrat e pagesës dhe llogaritja e mbetjes
MBETJE LEKE	80,00		
VLERA PA TVSH B	50,00		Vlerat pa TVSH sipas shkallëve tatimore
20%		10,00	Vlerat për shkallë tatimore
TVSH B 20%	54,00		
VLERA PA TVSH C	5,45		
10%	104,55		Vlera totale e shitur pa TVSH
TVSH C 10%	15,45		Vlera totale e TVSH së shitur
TOT. VL. PA TVSH			
TOTALE TVSH			
NR. XXXXXXXXXX			Numri i identifikimit të pajisjes fiskale fiskal
DATA: 20/05/2008 13:11			Numri i pajisjes fiskale (identifikimin e tij në rrjet p.sh supermarket) dhe operatori që ka shërbyer,
KUPONI TATIMOR Nr. 20			data dhe ora,
			numri i kuponit tatimor
			Logo fiskale
			

Numri i identifikimit dhe logo fiskale janë shenjat dalluese që kuponi më sipër është KUPON TATIMOR.

Kuptimi i tyre është:

Kuponi numër 20 (numër rendor pas mbylljes tatimore ditore) është kupon tatimor, pasi është lëshuar nga pajisja fiskale me numër identifikimi “XXXXXXXXXX” dhe i instaluar në Republikën e Shqipërisë me autorizim të Ministrisë së Financave.

Çdo kupon që nuk përmban këto shenja dalluese nuk është i natyrës tatimore.

2.3 Kopja e kuponit tatimor, prezantimi grafik dhe kuponi jotatimor

Çdo kupon tatimor që lëshohet shoqërohet me regjistrim të menjëhershëm në qarkun e shiritit të kontrollit elektronik, është e mundur gjithashtu të printohet dhe kopja e tij, e cila i ka të gjitha të dhënat e kuponit tatimor të sapolësuar, por kjo kopje është e formës KUPON JOTATIMOR.

Prezantimi grafik i kopjes së kuponit tatimor:

EMRI I TATIMPAGUESIT		Koka e kuponit
ADRESA		
NUMRI I NIPT-it logo grafike e tij		
.....		
INFO JOTATIMORE		
KOPJA E KUPONIT TATIMOR NR. 20		Tregon numrin e kuponit tatimor për të cilin lëshohet kopja
	LEKE	
1 x 60,00		
CAJ	60,00 B	
1x60,00		
KAFE	60,00 C	
NENTOTALE	120,00	
TOTALE LEKE	120,00	
PARA NË DORË	200,00	
MBETJE LEKE	80,00	
VLERA PA TVSH B 20%	50,00	
TVSH B 20%		
VLERA PA TVSH C 10%	10,00	
TVSH C 10%	54,00	
TOT. VL. PA TVSH	5,45	
TOTALE TVSH	104,55	
	15,45	
NR. XXXXXXXXXXXX		Kopja e kuponit tatimor regjistrohet në numërorin e kuponëve jotatimorë
DATA: 20/05/2008 13:11		
KUPON JO TATIMOR Nr. 2		
INFO JOTATIMORE		

Vlerat e prezantuara në kopjen e kuponit tatimor nuk regjistrohet në shumën totale të qarkulluar dhe të regjistruar në memorien fiskale, por regjistrohet në qarkun e shiritit të kontrollit për kontrole të mundshme mbi numërorin e kuponëve jotatimorë.

Të gjitha veprimet që kryhen në regjimin e leximit dhe programimit, pasi printohen kuponët që lëshohen janë të natyrës KUPON JOTATIMOR dhe regjistrohen në numërorin e kuponëve jo tatimorë. Shenja dalluese e këtyre kuponëve është se në kokën dhe në këmbën e kuponit shënohet sigla “INFO JOTATIMORE” dhe në këta kuponë nuk shënohet logo fiskale dhe numri i identifikimit të pajisjes të cila janë shenja dalluese të KUPONIT TATIMOR.

2.4 Funksione ndihmëse të pajisjes fiskale në përpunimin e kuponit tatimor

- Pajisja fiskale lejon të kryejë funksione të tilla, si:

- Fshirja e një rreshti (artikull të regjistruar);
- Anulimi i një artikulli;
- Anulimi i kuponit;
- Ulje ose rritje në % të artikullit të regjistruar;
- Ulje ose rritje në vlerë të artikullit të regjistruar.

Këto funksione janë të mundur vetëm në fazën e regjistrimit të shitjes dhe pa kryer mbylljen e kuponit tatimor. Në qoftë se tatimpaguesi e mbyll regjistrimin dhe lëshon kuponin tatimor pa kryer një nga këto funksione, çdo veprim i mëtejshëm, lidhur me një nga këto funksione është i pamundur. Pajisja fiskale fiskal nuk lejon asnjë formë ndryshimi të informacionit të regjistruar në memorien operative dhe QSHKE. Kuponët tatimorë gabim duhet të ruhen nga tatimpaguesit, të cilët e pasqyrojnë ndryshimin në mënyrë manuale në kontabilitetin e tyre dhe të pasqyrohet në librin e raporteve.

a) Procedura e fshirjes së një artikulli, prezantimi grafik i kuponit

EMRI I TATIMPAGUESIT	
ADRESA	
NUMRI I NIPT-it	
logo grafike e tij	
	LEKE
1 x 200,00	
BLUZE	200,00 B
1 x 300,00	
KËMISHE	300,00 B
FSHIJ RRJESHT	
1 x 200,00	
BLUZE	-200,00 B
NENTOTALE	300,00
TOTALE LEKE	300,00
PARA NË DORË	
MBETJE LEKE	
VLERA PA TVSH	250,00
20%	
TVSH B 20%	50,00
NR. XXXXXXXXXX	
DATA: 21/05/2008 13:11	
KUPONI TATIMOR Nr. 23	
	

b) Procedura e anulimit të artikullit, prezantimi grafik i kuponit

EMRI I TATIMPAGUESIT	
ADRESA	
NUMRI I NIPT-it	
logo grafike e tij	
	LEKE
1 x 200,00	
BLUZË	200,00 B
ANULIM	
BLUZE	-200,00 B
1 x 300,00	
KËMISHË	300,00 B
NËNTOTALE	300,00
TOTALE LEKË	300,00
PARA NË DORË	
MBETJE LEKË	
VLERA PA TVSH	250,00
20%	
TVSH B 20%	50,00
NR. identifikimit: XXXXXXXXXXXX	
DATA: 21/05/2008 13:11	
KUPONI TATIMOR Nr. 24	
	

c) Procedura e anulimit të kuponit, prezantimi grafik i kuponit

EMRI I TATIMPAGUESIT	
ADRESA	
NUMRI I NIPT-it	
logo grafike e tij	
	LEKE
1 x 200,00	
BLUZE	200,00 B
1 x 300,00	
KËMISHA	300,00 B
FSHIRJE TOTALE KUPONIT	
	-500,00 B
NËNTOTALE	0,00
TOTALE LEKË	0,00
PARA NË DORË	
MBETJE LEKË	
NR. XXXXXXXXXXXX	
DATA: 21/05/2008 13:11	
KUPONI TATIMOR Nr.25	
	

d) Funksioni i uljes ose rritjes së vlerës në %, prezantimi grafik i kuponit

EMRI I TATIMPAGUESIT	
ADRESA	
NUMRI I NIPT-it	
logo grafike e tij	
	LEKE
1 x 200,00	
BLUZË	100,00 B
% ULJE PËR 10%	-10,00
1 x 300,00	
KËMISHA	200,00 B
% RRITJE PËR 10%	20,00
NENTOTALE	310,00
TOTALE LEKË	310,00
PARA NË DORË	
VLERA PA TVSH B	258,33
20%	
TVSH B 20%	51,67
NR. XXXXXXXXXXXX	
DATA: 21/05/2008 13:41	
KUPONI TATIMOR Nr. 26	
	

e) Funksioni i uljes ose rritjes së vlerës në vlerë, prezantimi grafik i kuponit

EMRI I TATIMPAGUESIT	
ADRESA	
NUMRI I NIPT-it	
logo grafike e tij	
	LEK
1 x 200,00	
BLUZË	100,00 B
ULJE PËR ART.	-10,00
1 x 300,00	
KËMISHA	200,00 B
RRITJE . PËR ART	20,00
NËNTOTALE	310,00
TOTALE LEK	310,00
PARA NË DORË	
VLERA PA TVSH B	258,33
20%	
TVSH B 20%	51,67
NR. XXXXXXXXXXXX	
DATA: 21/05/2008 13:42	
KUPONI TATIMOR Nr. 27	
	

2.5 Kuponi tatimor nga fatura tatimore, prezantimi grafik

Tatimpaguesi që ka detyrimin për përdorimin e pajisjes fiskale në shitjen e mallrave dhe shërbimeve dhe që sipas kërkesave të ligjit ka lëshuar faturë tatimore është i detyruar të lëshojë edhe kuponin tatimor referuar kësaj fature në të cilin ka të evidentuar edhe numrin e faturës që ky kupon shoqëron, në rastet kur pagesa bëhet me lekë në dorë. Kjo është e mundur përmes funksionit të “Kupon tatimor për faturë tatimore” në pajisjen fiskale. Për të mos pasur dyfishim të vlerave, regjistrimi i faturës tatimore është i specifikuar në detajet e raportit tatimor ditor nga pajisja fiskale, në mënyrë që tatimpaguesi të ketë të evidentuar xhiron ditore përmes kuponëve tatimor (pa faturë tatimore) dhe xhiron ditore të kuponëve tatimor referuar faturave tatimore. Në librin e shitjeve mujore i cili tregon shumën e shitjeve gjithsej të realizuar nga tatimpaguesi do të deklarohet në FDP-në mujore, shumën e faturave të regjistruara në rend kronologjik dhe shumat e kuponëve pa faturë tatimore.

EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it logo grafike e tij	Koka e kuponit
FATURA TATIMORE NR. 150 LEK	Tregon numrin e faturës tatimor që i referohet kuponit tatimor
DOLLAP 12.000,00 NËNTOTALE 12.000,00 TOTALE LEK 12.000,00 PARA NË DORË	Emërtimet e artikujve të shitur me faturë
VLERA PA TVSH B 10.000,00 20% TVSH B 20% 2.000,00	Vlera pa TVSH Vlera e TVSH
NR. : XXXXXXXXXX DATA: 21/05/2008 13:45 KUPONI TATIMOR Nr. 29	Numri i identifikimit të pajisjes fiskale fiskal Numri i pajisjes fiskale (identifikimin e tij në rrjet p.sh. supermarket) dhe operatori që ka shërbyer, Data dhe ora, Numri i kuponit tatimor që i referohet faturës tatimore
	Logo fiskale

3. Prezantimi grafik i raporteve në regjimin e leximit (X)

Regjimi i leximit (X) shërben për të ndihmuar tatimpaguesin mbi mbarëvajtjen e aktivitetit, kontroll mbi xhiron ditore, statistika të ndryshme etj. Të gjitha këto raporte që lëshohen në këtë regjim janë të natyrës “JOTATIMORE”. Dallimi midis raporteve jotatimore dhe tatimore është:

- Koka e raportit në të cilën shënohet tipi i raportit dhe regjimit;
- Sigla “RAPORT JOTATIMOR” në fillim dhe në fund të kuponit;
- Mungesa në kupon i “LOGOS FISKALE” dhe “NUMRIT TË IDENTIFIKIMIT” të pajisjes fiskale.
- Nuk printohet përmbledhja totale e memories fiskale.

Raportet e leximit mbi xhiron janë të paraqitur me vlera për një xhiro të bërë me interval nga fillimi i ditës deri në momentin e printimit të raportit.

EMRI I TATIMPAGUESIT	
ADRESA	
NUMRI I NIPT-it	
logo grafike e tij	
RAPORT JOTATIMOR	
RAPORTI TATIMOR DITOR	X
SHITJET	
KLIENTË TË SHËRBYER	12
TOTALI BRUTO	14.220,00
ULJE	
4	22,00
RRITJE	
3	44,00
TOTALI NETO	14.242,00
RIKTHIM MALLI	
1	600,00
ANULIME	
2	500,00
FSHIJ RRJESHTIN	
1	200,00
TOTALE E ANULUAR	
1	500,00
KUPONA TATIMORE	
12	14.242,00
PARA NË DORË	
11	14.042,00
TVSH	
TOTALET	
VLERA PA TVSH	11.872,88
TVSH	2.369,12
XHIRO DITORE	14.242,00
NGA TË CILAT	

KUPONA TATIMOR	
SHKALLA E TVSH B: 20%	
VLERA PA TVSH	1.818,33
TVSH	363,67
TOTALE PËR SHKALLË	2.182,00
SHKALLA E TVSH C: 10% (shembull për shkallë të tjera)	
VLERA PA TVSH	54,55
TVSH	5,45
TOTALE PËR SHKALLË	60,00
TOTALE	
VLERA PA TVSH	1872,88
TVSH	369,12
TOTALE PËR KUPONA	2242,00
KUPONA NGA FATURA TATIMORE	
SHKALLA E TVSH B: 20%	
VLERA PA TVSH	10.000,00
TVSH	2.000,00
TOTALE PËR SHKALLË	12.000,00
TOTALE	
VLERA PA TVSH	10.000,00
TVSH	2.000,00
TOTALE KUP. NGA FAT.	12.000,00
GJENDJA E ARKËS	
PARA NË DORË	
11	14.042,00
DATA: 21/05/2008 13:45	
KUPON JOTATIMOR Nr. 5	
RAPORT JOTATIMOR	

Shpjegime:

1. Koka e raportit dhe emërtimi i tij;
2. Detajet mbi shitjet ditore;
3. Totale e xhiros ditore;
4. Detaje mbi totalen e xhiros ditore;
5. Gjendja e arkës;
6. Këmba e raportit.

a) Koka e raportit dhe emërtimi i tij

Në këtë pjesë specifikohet tipi i raportit që shërben dhe për identifikimin e tij që mund të jetë “JOTATIMOR” ose “TATIMOR”. Identifikimi bëhet përmes siglës së regjimit (X) dhe emërtimit “RAPORT JOTATIMOR”.

b) Detajet mbi shitjet ditore

Në këtë pjesë prezantohen si përmbledhje e gjithë puna e kryer gjatë ditës deri në çastin e printimit të këtij raporti. Informacioni mund të bëhet i përmbledhur në një rresht ose mund të jetë dhe në dy rreshta:

P.sh.

Në 1 rresht

KLIENTË TË SHËRBYER	12	- Tregon sa klientë janë shërbyer gjatë ditës deri në momentin e printimit të raportit
TOTALI BRUTO	14.22	- Tregon sa është vlera bruto e shitur pallogaritur
	0,00	uljet apo rritjet

Në 2 rreshta

ULJE		- Rreshti i parë tregon çfarë është kryer
4	22,00	- Rreshti i dytë tregon sa herë është kryer dhe vlera totale

c) Totale e xhiros ditore

Në këtë pjesë prezantohet e gjithë xhiroja e kryer deri në momentin e printimit të raportit e cila është e ndarë në vlerën pa TVSH dhe sa është totale e TVSH. Kjo totale përmbledh sa është shitur me kuponë tatimore dhe me kuponë nga fatura tatimore.

d) Totale mbi detajet e xhiros ditore

Në këtë pjesë është e detajuar totale e xhiros ditore sipas formave të shitjes: sa është shitur me kuponë tatimore e detajuar sipas shkallëve tatimore dhe e përmbledhur në total dhe sa është shitur me kuponë tatimore referuar faturave tatimore të detajuar sipas shkallëve tatimore dhe e përmbledhur në total.

e) Gjendja e arkës

Identifikon sa është gjendja e arkës në monedhë dhe sa herë është paguar me para në dorë.

f) Këmba e raportit

Në këtë pjesë prezantohet se ky raport nga cila pajisje fiskale fiskal është printuar (për pajisjet fiskale në rrjet) dhe nga cili operator është kërkuar raporti, në çfarë date dhe ore. Të gjithë raportet jotatimore përmbledhen në numërorin e kuponëve jotatimore. Në fund të kuponit printohet sigla “ RAPORT JOTATIMOR” për ta konfirmuar tipin e raportit.

4. Prezantimi grafik i raportit tatimor ditor – regjimi i mbylljes (Z)

Raporti tatimor ditor shërben për të kryer mbylljen ditore të aktivitetit. Vlerat totale të raportit përmbledhen në totalen e memories fiskale. Këto vlera tatimpaguesi i regjistron në librin e raporteve dhe në kontabilitetin e tij. Raporti tatimor ditor përmbledh gjithë punën e kryer gjatë ditës nga tatimpaguesi dhe vlerat që përmbledhen në këtë raport janë pjesë e raportit periodik që pajisja fiskale dërgon në DPT. Raporti tatimor ditor përgatitet në regjimin (Z) të pajisjes fiskale fiskal. Ky raport është i përbërë nga:

a) Koka e raportit dhe emërtimi i tij;

- b) Detajet mbi shitjet ditore;
- c) Totale e xhiros ditore;
- d) Detaje mbi totalen e xhiros ditore;
- e) Gjendja e arkës;
- f) Përmbledhja e përgjithshme e totaleve në memorien fiskale;
- g) Këmba e raportit.

Shenjat dalluese të raportit tatimor ditor janë:

- a) Koka e raportit në të cilën shënohet tipi i raportit dhe sigla e regjimit;
- b) Sigla “RAPORT TATIMOR” në fund të kuponit;
- c) Printimi i “LOGOS FISKALE” dhe “NUMRIT TË IDENTIFIKIMIT” të pajisjes fiskale në raport.
- d) Printimi i përmbledhjes totale të memories fiskale.

Pas printimit të raportit tatimor ditore numërori i KUPONËVE TATIMORË dhe i KUPONËVE JOTATIMORË që janë lëshuar gjatë ditës zerrohen.

EMRI I TATIMPAGUESIT	
ADRESA	
NUMRI I NIPT-it	
logo grafike e tij	
RAPORT TATIMOR	
RAPORTI TATIMOR DITOR	Z
SHITJET	
KLIENTË TË SHËRBYER	12
TOTALI BRUTO	14.220,00
ULJE	
4	22,00
RRITJE	
3	44,00
TOTALI NETO	14.242,00
RIKTHIM MALLI	
1	600,00
ANULIME	
2	500,00
FSHIJ RRJESHTIN	
1	200,00
TOTALE E ANULUAR	
1	500,00
KUPONË TATIMORË	
29	14.242,00
PARA NË DORË	
11	14.042,00
TVSH	
TOTALET	
VLERA PA TVSH	11.872,88
TVSH	2.369,12
XHIRO DITORE	14.242,00
NGA TË CILAT	
KUPONË TATIMORË	
SHKALLA E TVSH B: 20%	
VLERA PA TVSH	1.818,33
TVSH	363,67
TOTALE PËR SHKALLË	2.182,00
SHKALLA E TVSH C: 10%	
VLERA PA TVSH	54,55
TVSH	5,45
TOTALE PËR SHKALLË	60,00
TOTALE	
VLERA PA TVSH	1872,88
TVSH	369,12
TOTALE PËR KUPONË	2242,00
KUPONË NGA FATURA TATIMORË	
SHKALLA E TVSH B: 20%	
VLERA PA TVSH	10.000,00
TVSH	2.000,00
TOTALE PËR SHKALLË	12.000,00

1

2

3

4

TOTALET	
VLERA PA TVSH	10.000,00
TVSH	2.000,00
TOTALE KUPONË NGA FAT.	12.000,00
GJENDJA E ARKËS	
PARA NË DORË	
11	14.042,00
RAPORTI TATIMOR DITOR NUM	33
NDËRRHYRJE TEKNIKE	0
KUPONA TATIMORË	30
KUPONA JOTATIMORË	5
TOTALET E PËRGJITHSHME:	
XHIRO DITORE B	2.758.452,51
XHIRO DITORE C	60,00
SHUMA TOTALE	2.758.512,51
TVSH B	459.742,10
TVSH C	5,45
TOTALE TVSH	459.747,55
KUPONA TATIMORË	56
TRANSMETIMI PO	
NR.: XXXXXXXXXXXX	
DATA: 21/05/2008 21:45	
KUPONI TATIMOR Nr. 30	
	
RAPORT TATIMOR	

5

6

7

Shpjegime:

a) Koka e raportit dhe emërtimi i tij

Në këtë pjesë specifikohet tipi i raportit që shërben dhe për identifikimin e tij. Identifikimi bëhet përmes siglës së regjimit (Z) dhe emërtimit “RAPORT TATIMOR”.

b) Detajet mbi shitjet ditore

Në këtë pjesë prezantohen si përmbledhje e gjithë puna e kryer gjatë ditës. Informacioni mund të bëhet i përmbledhur në një rresht ose mund të jetë dhe në dy rreshta.

P.sh.

Në 1 rresht

KLIENTË TË	12	- Tregon sa klientë janë shërbyer gjatë ditës deri në momentin e printimit të raportit
SHËRBYER		
TOTALI BRUTO	14.22	- Tregon sa është vlera bruto e shitur pallogaritur uljet apo rritjet
	0,00	

Në 2 rreshta

ULJE		- Rreshti i parë tregon çfarë është kryer
4	22,00	- Rreshti i dytë tregon sa herë është kryer dhe vlera totale

c) Totale e xhiros ditore

Në këtë pjesë prezantohet e gjithë xhiroja ditore e kryer, e cila është e ndarë në vlerën pa TVSH dhe sa është totale e TVSH. Kjo totale përmbledh sa është shitur me kuponë tatimorë dhe me kuponë nga fatura tatimore. Këto vlera shkruhen në librin e raporteve.

d) Totale mbi detajet e xhiros ditore

Në këtë pjesë është e detajuar totale e xhiros ditore sipas formave të shitjes: sa është shitur me kuponë tatimorë e detajuar sipas shkallëve tatimore dhe e përmbledhur në total dhe sa është shitur me kuponë tatimorë referuar faturave tatimore të detajuar sipas shkallëve tatimore dhe e përmbledhur në total.

e) Gjendja e arkës

Identifikon sa është gjendja e arkës në monedhë dhe sa herë është paguar me para në dorë.

f) Përmbledhja e përgjithshme e totaleve në memorien fiskale

Në këtë pjesë paraqitet vlerat totale të regjistruar në memorien fiskale që nga dita e fiskalizimit të pajisjes fiskale deri në ditën që po shqyrtohet.

g) Këmba e raportit

Në këtë pjesë printohet rezultati i transmetimit, NUMRI I IDENTIFIKIMIT të pajisjes fiskale, numri i regjistruesit nga cila pajisje fiskale është printuar raporti (për pajisjet fiskale në rrjet) dhe nga cili operator, në çfarë date dhe ore. Të gjithë raportet tatimor regjistrohen në numërorin e kuponëve tatimorë të memories fiskale. Në fund të kuponit printohet LOGO FISKALE sigla “ RAPORT TATIMOR” për ta konfirmuar tipin e raportit.

5. Prezantimi i kuponit dhe raporteve që kryhen në funksionin e trajnimit

Në këtë fazë gjithë hapësirat në kuponët e lëshuar duhet të mbushen nga simboli “?” dhe në kokën, qendrën dhe këmbën e kuponit vendoset sigla “INFO JOTATIMORE”.

Shembull i kuponit:

EMRI I TATIMPAGUESIT	
ADRESA	
NUMRI I NIPT-it	
logo grafike e tij	
LEK	
INFO JOTATIMORE	
1?x?60,00	
KAFE	60,00?B
TOTALE? LEK	60,00
PARA? NË? DORË	
VLERA?PA?TVSH?B?20	50,00
TVSH?B?20%	10,00
INFO?JO?TATIMORE	
Nr identifi.001 OPERATORI?1	
DATA: 20-05-2008 13:11	
KUPON TATIMOR Nr.2	
INFO JO TATIMORE	

E njëjta procedurë është e vlefshme dhe për raportet që lëshohen në këtë regjim. Të gjitha fushat boshe mbushen me shenjë “?” dhe në mënyrë të përsëritur mbi raport shënohet sigla “INFO JOTATIMORE”.

6. Certifikimi i pajisjeve fiskale

Shoqëritë e autorizuar për furnizimin e pajisjeve fiskale, janë të detyruara të miratojnë tipin pajisjeve që do të hedhin në treg, në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, e cila verifikon nëse tipi i pajisjes fiskale është sipas karakteristikave të përcaktuara me ligj. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dërgon pranë Komisionit të Ministrisë së Financave vendimin e miratimit dhe një raport teknik për çdo model të pajisjeve fiskale të miratuar, ku përveç të dhënave teknike të modelit duhet të përmbajë edhe të dhëna identifikuese të modelit (kodin e shoqërisë dhe kodin e modelit). Shoqëritë e autorizuar janë të detyruara të paraqiten pranë komisionit të ngritur në Ministrinë e Financave për të verifikuar përputhshmërinë e pajisjes që do të hedhin në treg me kërkesat ligjore të kërkuara nga këto pajisje. Komisioni verifikon procedurën e miratimit të tipit, dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria dhe verifikon përputhshmërinë e pajisjes dhe pajis ose jo, shoqërinë e autorizuar me një autorizim për lejimin e shitjes së kësaj pajisje në tregun shqiptar. Për çdo ndryshim në pajisjen fiskale (ndryshim pjesë përbërëse apo firmware) shoqëritë e autorizuar duhet të kryejë këtë procedurë nga e para.

Komisioni mund të kërkojë nga shoqëritë demonstrim të të gjitha funksionaliteteve të pajisjes fiskale për të cilën kanë aplikur për autorizim.

Pajisja fiskale, tipi i së cilës do të aprovohet për shitje do të qëndrojë pranë komisionit i cili e dërgon atë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për prezantim viziv, trajnim të administratës tatimore dhe ruajtje të saj për verifikime dhe ballafaqime me pajisjet e shitura në treg.

7 Procedura e pajisjes me pajisje fiskale për tatimpaguesit

1. Tatimpaguesi:

a) Zgjedh modelin e pajisjes fiskale sipas nevojave të tij;

- b) Plotëson formularin e kërkesës për pajisjen me pajisje fiskale pranë shoqërisë së autorizuar, në 3 tre kopje, nga të cilat një e mban vetë;
- c) Dorëzon një kopje të dokumenteve identifikuese të subjektit (kopje e NIPT-it të noterizuar);
- d) Lidh kontratën me shoqërinë e autorizuar përmbajtja e së cilës mbështetet në legjislacionin në fuqi mbi detyrimet e palëve dhe bën pagesën e pajisjes fiskale;
- e) Dorëzon pranë shoqërisë së autorizuar listën e të dhënave që duhet të programohen në kasë (lista e mallrave/shërbimeve (artikujve), çmimet etj...);
- f) Asiston në fiskalizimin e pajisjes dhe verifikon të dhënat e inicializuara;
- g) Trajtohet nga shoqëria e autorizuar për përdorimin e pajisjes fiskale dhe firmos deklaratën e trajnimit;
- h) Pajiset me manualin e përdorimit të pajisjes fiskale në gjuhën shqipe, ku përveç të tjerave, në manual paraqiten pikat e shërbimit si edhe numrat e kontaktit;
- i) Sigurohet që pajiset me të gjitha elementet që shoqërojnë pajisjen fiskale (modem, karta SIM);
- j) Verifikon funksionalitet bazë të pajisjes (shitje, mbyllje ditore, transmetim të të dhënave).

2. Shoqëria e autorizuar:

- a) Shoqëria e autorizuar regjistron të dhënat identifikuese të tatimpaguesit në programin e ofruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duke i hapur një kartelë elektronike për një pajisje fiskale;
- b) Pajis me një kontratë shërbimi tatimpaguesin të cilin e bën pjesë të kontratës;
- c) Një kopje të formularit të kërkesës së bashku me fotokopjen e faturës e dërgon në drejtorinë tatimore rajonale të tatimpaguesit;
- d) Bën përgatitjen (lidhjen me pajisje të tjera ndihmëse: lexues të kartave bankare, pajisjet e transmetimit *on line* etj...) dhe programimin e pajisjes fiskale sipas nevojave të tatimpaguesit;
- e) Bën kontrollin teknik dhe vulosjen e pajisjes fiskale;
- f) Bën fiskalizimin e pajisjes fiskale;
- g) Dërgon teknikun përkatës për instalimin e pajisjes fiskale në mjediset e tatimpaguesit;
- h) Bën trajnim e tatimpaguesit për përdorimin e pajisjes fiskale dhe ruan deklaratën e trajnimit të nënshkruar nga tatimpaguesi dhe përfaqësuesit të shoqërisë në dy kopje (secili nga një kopje).

8. Numri i identifikimit të pajisjes fiskale

Për të mos pasur konflikte të numrave të identifikimit të pajisjeve fiskale, numri i identifikimit të pajisjes është i përbërë nga dy pjesë të cilat së bashku garantojnë siguri për pajisjen fiskale.

Pjesa e parë

Identifikimi i shoqërive të autorizuar përmes dy germave që i ka vendosur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Emri i shoqërisë së autorizuar	Kodi identifikues
A.E. Distribution sh.p.k.	AE
I.V.A. Elektronik sh.p.k	IV
B.N.T. Electronics sh.p.k.	BN
CKV NUSHI-CFV NOKI	CK
Rilindja sh.p.k. dhe PKP sh.p.k	RL

Modelet e pajisjeve fiskale. Secila nga pajisjet që janë të autorizuar për shitje në tregun shqiptar do të identifikohet nga 2 shifra që fillojnë nga 00-99 për secilën shoqëri.

Shoqëria	Kodi i shoqërisë	Kodi i modelit
A.E. Distribution sh.p.k.	AE	Nga 00 - Në 99
I.V.A. Elektronik Sh.p.k	IV	Nga 00 - Në 99
BNT Electronics Sh.p.k.	BN	Nga 00 - Në 99
CKV NUSHI-CFV NOKI	CK	Nga 00 - Në 99
Rilindja S.p.k. dhe P.K.P sh.p.k	RL	Nga 00 - Në 99

Pjesa e dytë

Numri serial i pajisjes është një numër që e lëshon fabrika prodhuese. Secila nga shoqëritë për çdo model që mer autorizim për shitje ka mundësinë të prodhojë nga seriali 000000 deri në 999999 pajisje. Të dyja këto pjesë përbëjnë numrin e identifikimit i cili i regjistrohet pajisjes fiskale vetëm një herë në momentin fillestar dhe është i pandryshueshëm.

Shembull

Shoqëria	Kodi	Kodi mod.	Seriali
A.E. Distribution Sh.p.k.	AE	00-99	Nga 000000 – Në 999999
I.V.A. Elektronik Sh.p.k	IV	00-99	Nga 000000 – Në 999999
Toshiba BNT Elektronik Sh.p.k.	BN	00-99	Nga 000000 – Në 999999
CKV NUSHI-CFV NOKI	CK	00-99	Nga 000000 – Në 999999
Rilindja S.p.k.	RL	00-99	Nga 000000 – Në 999999

Shoqëria “Drejtorja e Përgjithshme” me kod identifikimi “DP” ka marrëautorizimin për pajisjen fiskale model “FUTURA” e cila identifikohet me kodin e modelit “12”.

Numrat e identifikimit të këtij modeli janë:

Fillojnë nga: DP12000000

Mbarojnë në: DP12999999

Vula identifikuese e teknikëve të autorizuar

Shoqëritë e autorizuar janë të detyruara të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve listën e teknikëve të autorizuar. Çdo teknik i autorizuar identifikohet përmes kodit të identifikimit të shoqërisë së autorizuar dhe kodit me shifra sipas renditjes në listën e shoqërive të autorizuar.

Shoqëria	Kodi i shoqërisë	Kodi i teknikut
A.E. Distribution sh.p.k.	AE	Nga 01 - Në 999
I.V.A. Elektronik sh.p.k	IV	Nga 01 - Në 999
Toshiba BNT Elektronik sh.p.k.	BN	Nga 01 - Në 999
CKV NUSHI-CFV NOKI	CK	Nga 01 - Në 999
Rilindja sh.p.k.	RL	Nga 01 - Në 999

Shoqëritë e autorizuar duhet të pajisin teknikët e tyre me goditësin (punconin) me kodet identifikuese të secilit prej tyre, në mënyrë që mbi vulën fiskale të pajisjes fiskale të shënohet kodi identifikues i teknikut që ka kryer fiskalizimin apo kontrollin periodik. I njëjti kod vendoset dhe në etiketat e kontrollit periodik dhe në dokumentacionin përkatës të pajisjes fiskale.

Teknikët e autorizuar nga shoqëritë për kryerjen e procedurave të fiskalizimit dhe kontrollit periodik mund t'i nënshtrohen testeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për të vlerësuar aftësitë e tyre. Shoqëritë e autorizuar duhet të dorëzojnë goditësin e teknikeve të larguar nga puna pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shembull.

Tekniku i autorizuar me initiale Z.Z. i shoqërisë së autorizuar “Drejtoria e Përgjithshme” me kod identifikimi “DP”, është i renditur në listën e teknikëve me numrin 01.

Kodi identifikues ose vula identifikuese e këtij tekniku është: DP01

Pajisja fiskale model “FUTURA” me numër identifikimi DP12000123 është fiskalizuar dhe kryer kontrolli teknik periodik nga tekniku i autorizuar DP01 i cili është i detyruar të ketë lënë shenjën DP01 në vulën fiskale dhe të ketë vendosur në pamjen ballore dhe të dukshme për publikun etiketën pozitive të kontrollit periodik duke specifikuar skadencat e tij në shkurt të vitit 2009.



9. Sistemi fiskal për regjistrimin e qarkullimit të shitjes me pakicë të derivative të naftës (stacionet e naftës, gazit)

Me dispenser nënkuptojmë një pompë apo një kolonë furnizimi me karburant në të cilin janë instaluar disa pistoleta furnizimi për lloje të ndryshme karburantesh dhe që komandohen me një qark (kokë) elektronik. Në një pikë shitjeje (stacione furnizimi) mund të jenë instaluar 1(një) apo disa dispenserë.

Në secilin prej dispenserave të karburantit, përfshirë dhe ata të GPL, është e detyruar të instalohet sistemi fiskal, KDE dhe pajisje fiskale.

Shkëmbimi i të dhënave bëhet në bazë të një protokolli të programuar sipas specifikave të dispenserit të karburantit.

Furnizimi me karburant duhet të jetë i lidhur saktësisht me regjistrimin e shitjeve dhe duhet të punojë nën rregullin e detyrueshëm “PA KUPON TATIMOR, S’KA KARBURANT”.

Të gjitha shitjet duhet të regjistrohen në pajisjen fiskale duke siguruar që informacioni i shitjeve të ruhet në memorien fiskale të pajisjes e instaluar pranë çdo dispenserit të pikës së karburantit.

KDE e lidhur në qarkun elektronik të dispenserit siguron transferimin e informacionit në pajisjen fiskale për shitjet e realizuara dhe komandon proceset e punës së dispenserit.

Sistemi fiskal duhet të sigurojë funksionin për:

Temperaturë të ambientit - 30°C / +55 °C;

Lagështia 5 % - 95 %

duhet të jetë i pajisur me certifikatat CE dhe ATEX, dhe programi logjik i pajisjes fiskale duhet të plotësojë të gjitha kriteret mbi pajisjet fiskale.

9.1 Lidhja e dispenserave të karburantit me pajisjen fiskale

a) Të dhënat mbi shitjen e karburantit duhen të ruhen automatikisht në pajisjen fiskale, si dhe në qarkun e shiritit të kontrollit. Vlerat e qarkulluara certifikohen në mënyrë automatike me lëshimin e kuponit tatimor nga pajisja fiskale.

b) Kuponi tatimor duhet të përmbajë:

- të dhënat identifikuese të shitësit;
- llojin e karburantit;
- sasinë e shitur;
- vlerën e karburantit të shitur (sipas çmimit të tabelës);
- vlerën e shitur sipas shkallës tatimore;
- vlerën e shkallës tatimore;
- numrin i dispenserit;
- numrin e identifikimit të pajisjes fiskale;
- datën, ora e shitjes;
- numërorin e kuponëve tatimorë;
- logon fiskale.

Emërtimi i llojeve të karburantit të jetë sipas miratimit nga institucionet e ngarkuara për këtë qëllim (Inspektorati Qendror Teknik).

Struktura e numrit të identifikimit të pajisjes fiskale për dispenserat dhe logo fiskale janë të njëjta me atë të përshkruara më lart në këtë udhëzim.

c) Puna e dispenserit ku është instaluar e pajisja fiskale bëhet nën kontrollin KDE, të lidhur sipas skemës dispenser-KDE-pajisje fiskale:

- Dispenseri duhet të punojë vetëm në regjimin automatik, nën kontrollin e sistemit fiskal, më saktë KDE. KDE komunikon me dispenserin sipas protokollit të caktuar, mban të memorizuar numërorin progresiv të dispenserit duke e freskuar atë pas çdo shitjeje. KDE vuloset në të njëjtat kushte si pajisja fiskale nga tekniku i autorizuar.

- Dispenseri do të vazhdojë të veprojë edhe kur pajisja fiskale pëson defekt të karakterit elektrik apo ndërprerje komunikimi me KDE, për 72 orë, derisa dëmtimi të rregullohet. Të dhënat e shitjeve të dispenserit gjatë këtij defekti ruhen në “KDE”, i vendosur në pjesën elektronike të dispenserit. Këto të dhëna regjistrohen automatikisht në memorien dhe në qarkun e shiritit të kontrollit të pajisjes fiskale menjëherë pas riparimit të defektit, vendosjes së komunikimit KDE me pajisjen fiskale, të dhëna të cilat do të paraqiten në raportin tatimor ditor “Z” të ditës kur është riparuar pajisja fiskale. Në rast defekti të sistemit, tatimpaguesi është i detyruar të lëshojë dëftesa tatimore për shitjet e kryera nën këtë regjim të cilat do të stornohen.

- Riparimi i pajisjes fiskale duhet të kryhet brenda 72 orëve nga shoqëria e autorizuar me të cilën tatimpaguesi ka kontratë mirëmbajtjeje pas kësaj kohe, kur defekti nuk është eliminuar, dispenseri duhet të bllokohet, të mos lëvrojë më lëng.

- Në rast se shkëputet lidhja midis KDE dhe qarkut elektronik të dispenserit, si dhe kur defekti i pajisjes fiskale nuk është eliminuar, dispenseri bllokohet. Dispenseri mund të lejohet të punojë në proces manual vetëm në rast se aprovohet nga administrata tatimore.

Menjëherë pas rilidhjes së dispenserit me KDE dhe vënies në punë të pajisjes fiskale, KDE kalkulon diferencat në vlerë absolute të numërorit pas rilidhjes me numrat e regjistruar në memorien e saj para defektit dhe e dërgon këtë informacion në pajisjen fiskale, duke e printuar automatikisht kuponin tatimor me çmimin e tabelës dhe duke e shënuar këtë kupon si shitje në regjimin me defekt.

Tekniku i shoqërisë së autorizuar duhet të paraqesë në librin e mirëmbajtjes të gjitha të dhënat e defektit (data ora kur filloi dhe mbaroi defekti përshkrimi i defektit).

- Në rast mbarimi të letrës ose koka e printerit të pajisjes fiskale është e hapur, dispenseri nuk duhet të jetë i aftë të veprojë.

d) Memoria fiskale duhet të ketë të njëjtat parametra teknikë të përshkruar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1476, datë 12.11.2008, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1286, datë 23.12.2009 dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.96, datë 17.2.2010.

e) Në memorien fiskale regjistrohen të dhënat e detajeve të raporteve tatimor ditor “Z”. Informacioni që duhet të regjistrohet në memorien fiskale është:

- Data (sipas formës data, muaji dhe viti);
- Totali i vlerës së qarkulluar sipas shkallës tatimore;
- Totali i vlerës së TVSH-së;
- Lloji i karburantit dhe sasia e shitur;
- Krah i dispenserit.

d) Të gjitha pikat e shitjes me pakicë të karburanteve duhet të pajisen me dispensera që të punojnë në mënyrë automatike, nën kontrollin e sistemit fiskal. Dispenseri mekanik duhet të zëvendësohet me dispenserin që ka mundësi lidhjeje me pajisjen fiskale përkufizuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1476, datë 12.11.2008, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1286, datë 23.12.2009 dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.96, datë 17.2.2010.

10. Shembuj të kuponit tatimor

Certifikimi i vlerës së qarkulluar mund të jetë sipas 4 mënyrave si më poshtë:

- a) Shitje normale;
- b) Shitje me tollon;
- c) Teste në dispenser = Nëse karburanti merret nga dispenserin me “qëllim testi, kontrolli ligjor”;
- d) Transferim në stacion = Nëse karburanti merret nga dispenserin për “qëllim transferimi” në stacion.

a) Shitje normale

Emri i tatimpaguesit	
Adresa	
Numri i NIPT-it	
(logo grafike e tij)	
10 LT x 125,00	
BENZIN	1.250,00
TOTAL	1.250,00
PARA NË DORË	1.250,00
VLERA ME TVSH 20%	1.041,67
TVSH 20%	208,33
DISPENSERI NR: 2	
NR. XXXXXXXXXX	
19-05-2008	Ora : 15:45
KUPONI TATIMOR : 20	
	

Të dhënat e tatimpaguesit

Tipi dhe vlera e qarkulluar

Vlera për shkallë tatimore

Numri i dispenser

Numri i identifikimit të pajisjes fiskale

Data, ora

Numëratori i kuponëve tatimorë

Logo fiskale

b) Shitje me tollon

Emri i tatimpaguesit	
Adresa	
Numri i NIPT-it (logo grafike e tij)	
10 LT x 125,00 BENZIN	1.250,00
TOTAL	1.250,00
TOLLON	1.250,00
VLERA ME TVSH 20 %	1.041,67
TVSH 20 %	208,33
DISPENSERI NR: 2	
NR. XXXXXXXXXXXX	
19-05-2008	Ora : 15:45
KUPONI TATIMOR : 20	
	

Të dhënat e tatimpaguesit

Tipi dhe vlera e qarkulluar

Vlera për shkallë tatimore

Numri i dispenser

Numri i identifikimit të pajisjes fiskale

Data, ora

Numërtori i kuponëve tatimorë

Logo fiskale

c) Kupon tatimor për "TEST"

Emri i tatimpaguesit	
Adresa	
Numri i NIPT-it (logo grafike e tij)	
TEST	
10 LT X 125,00 BENZIN	1.250,00
TOTAL	1.250,00
TEST	1.250,00
VLERA ME TVSH 20 %	1.041,67
TVSH 20 %	208,33
DISPENSERI NR: 2	
NR. XXXXXXXXXXXX	
19-05-2008	Ora : 15:45
KUPONI TATIMOR : 20	
	

Të dhënat e tatimpaguesit

TEST

Tipi dhe vlera e qarkulluar

Vlera për shkallë tatimore

Numri i dispenser

Numri i identifikimit të pajisjes fiskale

Data, ora

Numërtori i kuponëve tatimorë

Logo fiskale

d) Kupon tatimor për “TRANSFERIM”

Emri i tatimpaguesit	
Adresa	
Numri i NIPT-it (logo grafike e tij)	
TRANSFERIM	
10 LT X 125,00 BENZIN	1.250,00
TOTAL	1.250,00
TRANSFERIM	1.250,00
VLERA ME TVSH 20%	1.041,67
TVSH 20%	208,33
DISPENSERI NR: 2	
NR. XXXXXXXXXX	
19-05-2008	Ora : 15:45
KUPONI TATIMOR : 20	
	

Të dhënat e Tatimpaguesit

TRANSFERIM

Tipi dhe vlera e qarkulluar

Vlera për shkallë tatimore

Numri i dispenser

Numri i identifikimit të pajisjes fiskale

Data, ora

Numëratori i kuponëve tatimor

Logo fiskale

10.1 Raporti tatimor ditor “Z” në raste pa defekte

Emri i tatimpaguesit	
Adresa	
Numri i NIPT-it (logo grafike e tij)	
RAPORTI TATIMOR DITOR Z	

19-05-2008	Ora : 15:45
KUPONI TATIMOR : 21	
	Z0020
SHITJE NORMALE	
KARBURANT TIPI 1	100 LT
10 shitje	*150,00
KARBURANT TIPI 2	100 LT
13 shitje	*160,00
KARBURANT TIPI 3	100 LT
5 shitje	*170,00
KARBURANT TIPI 4	100 LT
15 shitje	*175,00
:	
PARA NË DORË	
25	*500,00
KARTË KREDITI	14
*1000,00	
NUMRI I FURNIZIMEVE:	20

Të dhënat e tatimpaguesit

Raporti tatimor ditor për shitjet e kryera në gjendje normale (pa defekte) e cili përmban çdo veprim të kryer për: TEST+TRANSFERTA+ SHITJE NORMALE

Detaje mbi shitjet për secilin tip të karburantit

Detaje mbi mënyrat e pagesës

KUPONA TATIMOR:	21
KUPONA JO TATIMOR:	63
-----SHKALLA TATIMORE-----	
SHKALLA E TVSH C: %10	
TOTALE PA TVSH	* 350,00
TVSH %10	*20,00
TOTALE PËR SHKALLË	* 370,00
:	
SHKALLA E TVSH B: %20	
TOTALE PA TVSH	* 450,00
TVSH %10	*25,00
TOTALE PËR SHKALLË	* 475,00

TOTALE	
TOTAL PA TVSH	*800,00
TVSH	*123,54
TOTALE PËR SHKALLË	*923,54

TEST	
KARBURANT TIPI 1	2 LT
1 test	*10,00
KARBURANT TIPI 2	4 LT
3 test	*16,00
KARBURANT TIPI 3	6LT
2 test	*170,00
KARBURANT TIPI 4	8 LT
4 test	*70,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:	5
TOTALE TEST	*1000,00
TVSH TEST	*250,00

TRANSFERIM	
KARBURANT TIPI 1	2 LT
1 transferim	*10,00
KARBURANT TIPI 2	4 LT
3 transferim	*16,00
KARBURANT TIPI 3	6LT
2 transferim	*170,00
KARBURANT TIPI 4	8 LT
4 transferim	*70,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:	5
TOTALE TRANSFERIM	*1000,00
TVSH TRANSFERIM	*250,00

---TOTALE SHITJE NORMALE ---	
TOTALE	*800,00
TVSH	*123,54
TOTALE TEST	*100,00
TVSH TEST	*13,54
TOTAL TRANSFERIM	*100,00
TVSH TRANSFERIM	*13,54
--- TOTALE E PËRGJITHSHME ---	
(NORMALE+DEFEKT)	

Detaje mbi shitjet për shkallë tatimore

Totale shitur pa periudhë defekti

Detaje mbi testet në stacion

Detaje mbi transferimet

Totalet

TOT+DEFEKT	*880,00
TVSH+DEFEKT	*70,00
TOT+DEFEKT	*880,00
TAX+DEFEKT	*73,00
TRANSMETIMI JO	
NR. XXXXXXXXXXXX	
	

Numri i identifikimit të pajisjes fiskale

Logo fiskale

10.2 Raporti tatimor ditor "Z" në rast defekti

Emri i tatimpaguesit	
Adresa	
Numri i NIPT-it	
(logo grafike e tij)	
RAPORTI TATIMOR DITOR Z	

19-05-2008	Ora : 15:45
KUPONI TATIMOR : 21	
	Z0020
SHITJE NORMALE	
KARBURANT TIPI 1	100 LT
10 shitje	*150,00
KARBURANT TIPI 2	100 LT
13 shitje	*160,00
KARBURANT TIPI 3	100 LT
5 shitje	*170,00
KARBURANT TIPI 4	100 LT
15 shitje	*175,00
:	
PARA NË DORË	
25	*500,00
KARTË KREDITI	14
*1000,00	
NUMRI I FURNIZIMEVE:	20
KUPONA TATIMOR:	21
KUPONA JO TATIMOR:	63
-----SHKALLA TATIMORE-----	
SHKALLA E TVSH C: %10	
TOTALE PA TVSH	* 350,00
TVSH %10	*20,00
TOTALE PËR SHKALLË	* 370,00
:	
SHKALLA E TVSH B: %20	
TOTALE PA TVSH	* 450,00
TVSH %10	*25,00
TOTALE PËR SHKALLË	* 475,00

TOTALE	
TOTAL PA TVSH	*800,00
TVSH	*123,54

Të dhënat e tatimpaguesit

Raporti tatimor ditor për shitjet e kryera në gjendje normale (pa defekte) e cili përmban çdo veprim të kryer për: TEST+TRANSFERTA+ +SHITJE NORMALE

Detaje mbi shitjet për secilin tip të karburantit

Detaje mbi mënyrat e pagesës

Detaje mbi shitjet për shkallë tatimore

Totale shitur pa periudhë defekti

TOTALE PËR SHKALLË	*923,54

TEST	
KARBURANT TIPI 1	2 LT
1 test	*10,00
KARBURANT TIPI 2	4 LT
3 test	*16,00
KARBURANT TIPI 3	6LT
2 test	*170,00
KARBURANT TIPI 4	8 LT
4 test	*70,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:	5
TOTALE TEST	*1000,00
TVSH TEST	*250,00

TRANSFERIM	
KARBURANT TIPI 1	2 LT
1 test	*10,00
KARBURANT TIPI 2	4 LT
3 test	*16,00
KARBURANT TIPI 3	6LT
2 test	*170,00
KARBURANT TIPI 4	8 LT
4 test	*70,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:	5
TOTALE TRANSFERIM	*1000,00
TVSH TRANSFERIM	*250,00

#####	
SHITJE ME DEFEKT	
DEFEKTI FILLOI:	19-08-08 10:45
DEFEKTI MBAROI:	19-08-08 12:30
DEFEKTI FILLOI:	19-08-08 13:45
DEFEKTI MBAROI:	19-08-08 15:30
DEFEKTI FILLOI:	19-08-08 16:45
DEFEKTI MBAROI:	19-08-08 17:30
KARBURANT TIPI 1	10 LT
2 Shitje	*15.000,00
KARBURANT TIPI 2	10 LT
2 Shitje	*16.000,00
KARBURANT TIPI 3	10 LT
3 Shitje	*17.000,00
KARBURANT TIPI 4	10 LT
3 Shitje	*17.500,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:	5

SHKALLA TVSH C: %10	*35.000,00
TVSH C: %10	*2.000,00
TOTALE PËR SHKALLË:	*37.000,00
SHKALLA TVSH B: %20	*45.000,00
TVSH B: %20	*5.000,00
TOTALE PËR SHKALLË	*50.000,00

Detaje mbi testet në stacion

Detaje mbi transferimet

Detaje mbi defektet dhe koha kur paisja fiskale ka pasur defekt

Detaje mbi shitjet pa kupon

Totalet mbi shitjet në defekt për shkallë tatimore

TOTALE DEFEKT	*80.000,00
TVSH DEFEKT	*7.000,00
TOTALE	*87.000,00

DEFEKT – SHITJE	
KARBURANT TIPI 1	10 LT
2 Shitje	*15.000,00
KARBURANT TIPI 2	10 LT
2 Shitje	*16.000,00
KARBURANT TIPI 3	10 LT
3 Shitje	*17.000,00
KARBURANT TIPI 4	10 LT
3 Shitje	*17.500,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:	5
TOTALE DEFEKT	*30.000,00
TVSH DEFEKT	*3.545,45
TOTALE	*33.545,45
#####	
TOTALE E PËRGJITHSHME (NORMAL + DEFEKTE)	
KARBURANT TIPI 1	10 LT
2 Shitje	*15.000,00
KARBURANT TIPI 2	10 LT
2 Shitje	*16.000,00
KARBURANT TIPI 3	10 LT
3 Shitje	*17.000,00
KARBURANT TIPI 4	10 LT
3 Shitje	*17.500,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:	5

SHKALLA TVSH C: %10	*35.000,00
TVSH C: %10	*2.000,00
TOTALE PËR SHKALLË:	*37.000,00
SHKALLA TVSH B: %20	*45.000,00
TVSH B: %20	*5.000,00
TOTALE PËR SHKALLË	*50.000,00

TOTALE NORMAL+DEFEKT	*80.000,00
TVSH NORMAL+DEFEKT	*7.000,00
TOTALE	*87.000,00

SHITJE E PËRGJITHSHME (NORMAL + DEFEKT)	
KARBURANT TIPI 1	10 LT
2 Shitje	*15.000,00
KARBURANT TIPI 2	10 LT
2 Shitje	*16.000,00
KARBURANT TIPI 3	10 LT
3 Shitje	*17.000,00
KARBURANT TIPI 4	10 LT
3 Shitje	*17.500,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:	5

Totalet

Detajet e shitjes me defekt të pajisjes fiskale mbi identifikimin e autonjetit

Totalet

Detaje mbi totalet e përgjithshme

TOTALE NORMAL+DEFEKT	*80.000,00
TVSH NORMAL+DEFEKT	*7.000,00
TOTALE	*87.000,00
#####	
---TOTALE SHITJE NORMALE ---	
TOTALE	*80.000,00
TVSH	*7.000,00
TOTALE TEST	*1.000,00
TVSH TEST	*250,00
TOTAL TRANSFERIM	*1.000,00
TVSH TRANSFERIM	*250,00
--- TOTALE SHITJE ME DEFEKT ---	
TOTALE DEFEKT	*80.000,00
TVSH DEFEKT	*7.000,00
--- TOTALE E PËRGJITHSHME ---	
(NORMALE+DEFEKT)	
TOT+DEFEKT	*87.000,00
TVSH+DEFEKT	*7.000,00
TOT+DEFEKT	*87.000,00
TAX+DEFEKT	*7.000,00
TRANSMETIMI PO	
NR. XXXXXXXXXXXX	
	

Numri i identifikimit të pajisjes fiskale

Logo fiskale

11. Raportet e memories fiskale

Raportet periodike tatimore të lëshuara nga leximi i memories fiskale duhet të jenë të tipave:

- Nga raporti tatimor ditor i parë Z – në raportin tatimor ditor Z të fundit.
- Për dy raporte tatimore ditore Z.
- Ndërmjet dy raporteve tatimore ditore Z.
- Ndërmjet një intervali të datave.
- Ndërmjet dy datave.

Raportet periodike janë objekt transmetimi manualisht nëse këto të fundit kërkohen nga administrata tatimore.

Raporti periodik i printuar përmban të gjitha të dhënat sipas tipit të përzgjedhjes dhe këto të dhëna janë të detajuara sipas formës së raportit tatimor ditor të prezantuar në shembullin e mësipërm.

12. Shoqëritë e tregimit të hidrokarbureve me shumicë

Në një pikë shitje karburanti me shumicë apo në magazina doganore është e detyruar të instalohet sistemi fiskal në çdo kalimatës.

Kalimatësi i nënshtrohet procedurave të verifikimit ligjor periodik nga DPM. Dokumentet e matjeve të kontrollit periodik dhe të vendosjes së pikave të sigurisë për të shmangur keqmanipulimin në kalimatës, të jenë në piken e shitjes me shumicë apo në magazinën doganore/tatimore. Kopje të tyre t'i jepet personit të autorizuar nga DPT.

Llogaritja e vëllimit të produktit të matur të bëhet në një temperaturë standarde prej 15°C sipas ligjit nr.8976, datë 12.12.2002, neni 37 pika 1.

Të gjitha shitjet/lëvrimet e karburantit duhet të regjistrohen në pajisjen fiskale duke siguruar që informacioni i shitjeve të ruhet në memorien fiskale.

KDE është e lidhur tek qarku elektronik i kalimatësit dhe siguron transferimin e informacionit, për sasinë e shitur/lëvruar të matur nga kalimatësi, në pajisjen fiskale dhe komandon proceset e punës së kalimatësit.

Sistemi fiskal duhet të sigurojë funksionin për:

Temperaturë të ambientit - 30°C / +55 °C

Lagështia 5 % - 95 %

duhet të jetë i pajisur me certifikatat CE, ATEX, dhe programi logjik i pajisjes fiskale duhet të plotësojë të gjitha kriteret mbi pajisjet fiskale.

12.1 Lidhja e kalimatësve me pajisjen fiskale

a) Të dhënat mbi shitjen e karburantit duhen të ruhen automatikisht në pajisjen fiskale si dhe në qarkun e shiritit të kontrollit. Vlerat e qarkulluara certifikohen në mënyrë automatike me lëshimin e kuponit tatimor nga pajisja fiskale i cili shoqëron faturën tatimore përkatëse.

b) Kuponi tatimor duhet të përmbajë:

- të dhënat identifikuese të shitësit;
- llojin i karburantit;
- sasinë e shitur;
- vlerën e karburantit të shitur;
- vlerën e shitur sipas shkallës tatimore;
- vlerën e shkallës tatimore;
- numrin e kalimatësit;
- numrin e identifikimit të pajisjes fiskale;
- datën, orën e shitjes;
- numërorin e kuponëve tatimorë;
- logon fiskale.

Struktura e numrit të identifikimit të pajisjes fiskale dhe logo fiskale janë të njëjtë me atë të përshkruar më lart në këtë udhëzim.

c) Në rast defekti elektrik të pajisjes fiskale apo shkëputje e lidhjes së saj me KDE, KDE ruan totalin e shitjeve për 72 orë. Të dhënat e shitjes/lëvrimit të kalimatësit gjatë kësaj periudhe kohe duhet të ruhen në KDE, i lidhur me pjesën elektronike të kalimatësit.

d) Pasi pajisja fiskale riparohet dhe lidhet me KDE, kjo e fundit i dërgon të dhënat e shitjes pajisjes fiskale në mënyrë automatike. Të dhënat e shitjes për periudhën e defektit, së bashku me shitjet normale do të paraqiten në raportin tatimor “Z” të ditës kur është riparuar pajisja fiskale, apo rivendosur lidhja. Gjatë defektit të pajisjes, pra dhe moslëshimit të kuponëve tatimorë, tatimpaguesi është i detyruar të lëshojë dëftesa tatimore për shitjet e kryera. Mbas 72 orëve në qoftë se defekti vazhdon, kalimatësi bllokohet dhe nuk lejohet të funksionojë.

KDE-ja mban të memorizuar numërorin progresiv të kalimatësit duke regjistruar atë pas çdo shitje. Në rast se shkëputet lidhja midis KDE-se dhe pajisjes fiskale, KDE-ja menjëherë pas rilidhjes kalkulon diferencën të numrit total të kalimatësit në momentin e rivendosjes së lidhjes me numrin total të kalimatësit para shkëputjes së lidhjes KDE-pajisje fiskale. Rezultatit e kalkuluar e dërgon në pajisjen fiskale e cila e paraqet në kuponin tatimor ditor në sektorin “shitje me defekt”.

KDE vulozet në të njëjtat kushte si pajisja fiskale nga tekniku i autorizuar.

e) Në rast mbarimi të letrës ose koka e printerit është e hapur; kalimatësi nuk duhet të jetë i aftë të veprojë.

f) Në memorien fiskale regjistrohen të dhënat e detajeve të raporteve tatimore ditore “Z”. Informacioni që duhet të regjistrohet në memorien fiskale është:

- Data (sipas formës data, muaji dhe viti);
- Totale e vlerës së qarkulluar sipas shkallës tatimore;
- Totale e vlerës së TVSH-së;
- Lloji i karburantit dhe sasia e shitur;
- Numri i kalimatësit.

13. Shembuj të kuponit tatimor

Certifikimi i vlerës së qarkulluar mund të jetë sipas 3 mënyrave si më poshtë:

a) Shitje normale.

b) Teste = nëse karburanti merret me “qëllim testi, kalibrimi”.

c) Transferim = nëse karburanti merret për “qëllim transferimi”.

a) Shitje normale

Emri i tatimpaguesit	
Adresa	
Numri NIPT-it (logo grafike e tij)	
Leximi progresiv i kalimatësit ?	
10000 LT x 120,00	
Benzin	1.200.000,00
TOTAL	1.200.000,00
VLERA ME TVSH 20 %	1.000.000,00
TVSH 20 %	200.000,00
kalimatësi nr: 2	
Nr. XXXXXXXXXX	
19-05-2008	Ora : 15:45
Kuponi tatimor : 20	
	

Të dhënat e tatimpaguesit

Tipi dhe vlera e qarkulluar

Vlera për shkallë tatimore

Numri i kalimatësit

Numri i identifikimit të pajisjes fiskale

Data, ora

Numratori i kuponëve tatimorë

Logo fiskale

b) Kupon tatimor për “test”

Emri i tatimpaguesit	
Adresa	
Numri NIPT-it (logo grafike e tij)	
test	
10000 LT x 120,00	
benzin	120.000,00
TOTAL	120.000,00
test	120.000,00
VLERA ME TVSH 20 %	100.000,00

Të dhënat e tatimpaguesit

Tipi dhe vlera e qarkulluar

Vlera për shkallë tatimore

TVSH 20%	20.000,00
kalimatës nr: 2	
NR. XXXXXXXXXX	
19-05-2008	Ora : 15:45
Kuponi tatimor : 20	
	

Numri i kalimatësit
 Numri i identifikimit të pajisjes fiskale
 Data, ora
 Numëratori i kuponëve tatimorë

Logo fiskale

c) Kupon tatimor për “Transferim”

Emri i tatimpaguesit	
Adresa	
Numri NIPT-it (logo grafike e tij)	
TRANSFERIM	
10000 LT X 120,00 BENZIN	1.200.000,00
TOTAL	1.200.000,00
TRANSFERIM	1.200.000,00
VLERA ME TVSH 20%	1.000.000,00
TVSH 20%	200.000,00
Kalimatës nr: 2	
Nr. XXXXXXXXXX	
19-05-2008	Ora : 15:45
Kuponi tatimor : 20	
	

Të dhënat e tatimpaguesit

TRANSFERIM

Tipi dhe vlera e qarkulluar

Vlera për shkallë tatimore

Numri i kalimatësit

Numri i identifikimit të pajisjes fiskale
 Data, ora
 Numëratori i kuponëve tatimorë

Logo fiskale

13.1 Raporti tatimor ditor “Z” në raste pa defekte

Emri i tatimpaguesit	
Adresa	
Numri NIPT-it (logo grafike e tij)	
Raporti tatimor ditor Z	

19.5.2008	Ora : 15:45
Kuponi tatimor : 21	
	Z0020
Shitje normale	
Karburanti tipi 1 10 shitje	1000000 LT *120,00
Numri i furnizimeve:	20
Kuponë tatimorë:	21
Kuponë jotatimorë:	63
-----shalla tatimore-----	
Shkalla e TVSH B: %20	
Totale pa TVSH	* 100.000.000,00
TVSH %20	*20.000.000,00
Totale për shkallë	* 120.000.000,00

Të dhënat e tatimpaguesit

Raporti tatimor ditor për shitjet e kryera në gjendje normale (pa defekte)

Detaje mbi shitjet për secilin tip të karburantit

Detaje mbi shitjet për shkallë tatimore

Totale shitje normale	
Totale	
Total pa TVSH	* 100.000.000,00
TVSH	*20.000.000,00
Totale për shkallë	*120.000.000,00
Transmetimi JO	
Nr. XXXXXXXXXX	
	

Totalet

Treguesi i transmetimit

Numri i identifikimit të pajisjes fiskale

Logo fiskale

13.2 Raporti tatimor ditor “Z” në rast defekti

Ky raport do të paraqitet sikurse pika 10.2 e këtij udhëzimi duke vendosur në të vetëm 1 tip karburanti.

13.3 Raportet e memories fiskale

Raportet periodike tatimore të lëshuara nga leximi i memories fiskale duhet të jenë të tipave:

- Nga raporti tatimor ditor i parë Z në raportin tatimor ditor Z të fundit.
- Për dy raporte tatimore ditore Z.
- Ndërmjet dy raporteve tatimore ditore Z.
- Ndërmjet një intervali të datave.
- Ndërmjet dy datave.

Raportet periodike janë objekt transmetimi manualisht nëse këto të fundit kërkohen nga administrata tatimore.

Raporti periodik i printuar përmban të gjitha të dhënat sipas tipit të përzgjedhjes dhe këto të dhëna janë të detajuara sipas formës së raportit tatimor ditor të prezantuar në shembullin e mësipërm.

14. Printimi i të dhënave

Printimi i të dhënave duhet të kryhet në shiritin (letrën) e pajisjes elektronike fiskale, e cila ruan të dhënat së paku për 5 vjet dhe që ka këto karakteristika:

Letra printuese e të dhënave duhet të ketë:

- normën e bardhësisë 85 % (të matur nga ELEPONI-m-UNI-7623/86);
- shkallën e butësisë 30 ml/s (BENDSTEN-UNI-7626/I/II/86);
- letër bazë $Ph > 7$.

15. Procedurat

15.1 Procedura e heqjes së memories fiskale për arsye të mbylljes së aktivitetit të shoqërisë apo personit fizik dhe zëvendësimi i saj me një memorie të re duke shfrytëzuar pajisjen ekzistuese (si hardware me një memorie të re) në emër të një shoqërie të re.

Në rastet kur një subjekt tatimpagues mbyll aktivitetin e tij në QKR dhe kërkon t’ia shesë pajisjen fiskale një subjekti tjetër, apo hap një subjekt të ri nëpërmjet procedurave të regjistrimit në QKR duke vazhduar të përdorë pajisjet e blera prej tij më parë për vazhdimin e aktivitetit të ri, ndiqet kjo procedurë:

Subjekti njofton organin tatimor me shkresë zyrtare se ka mbyllur aktivitetin e tij tregtar dhe ka bërë çregjistrimin e tij edhe në QKR dhe ia paraqet atë së bashku me kërkesën, shoqëruar me vendimin e mbylljes së aktivitetit në QKR, organit tatimor (drejtorisë tatimore rajonale) me kërkesën për ta përdorur atë (pajisjen fiskale) përsëri në një shoqëri të re.

Kjo kërkesë shoqërohet me të dhënat e formularit sipas modelit bashkëngjitur. Pas kësaj, ai, në komunikim me shoqërinë e autorizuar, bën zëvendësimin e memories së pajisjes fiskale të përdorur dhe fillon të deklarojë për llogari të shoqërisë së re me regjistrimet e memories së re të zëvendësuar të kësaj pajisjeje fiskale me një identifikim të ri të saj, shitjet

(xhiroja) e së cilës fillon me zero.

Në rastet e mbylljes së një aktiviteti tregtar të tatimpaguesit dhe shitjes së pjesës së mbetur si hardware (pa memorien fiskale dhe pa QSHKE), dorëzon memorien fiskale të shoqëria e autorizuar, e cila e administron atë si më lart së bashku me të gjithë dokumentacionin tjetër të mbylljes së aktivitetit dhe pas këtij veprimi subjekti mund ta shesë pjesën e mbetur.

Vetëm shoqëria e autorizuar mund ta kompletojë këtë pajisje (pjesën e mbetur) me elementet e reja (QSHKE, memorie fiskale) dhe të kryejë procedurat e fiskalizimit. Shoqëria e autorizuar mban në një regjistër të veçantë të gjitha këto pajisje që ndryshojnë numrin e identifikimit.

15.2 Procedura e reflektimit të një (apo disa gabimeve) të shtypura mbi pajisjen fiskale pa ndërgjegje nga ana e tatimpaguesit

Në rastet kur si rezultat i një gabimi të pavullnetshëm, nga ana e tatimpaguesit, është regjistruar një veprim shitjeje i porealizuar (gabim) dhe regjistrimi ka kaluar në memorien fiskale të pajisjes pa arkëtuar para nga ky veprim, procedura që do të ndiqet nga ana e tatimpaguesit do të jetë si më poshtë:

Tatimpaguesi do të bëjë prezent këtë gabim në organin tatimor (drejtorinë tatimore rajonale ku është i regjistruar) me një procesverbal (sipas modelit bashkëngjitur). Pas kësaj ai do të vazhdojë të raportojë shitjet, raportime të cilat do të vazhdojnë të regjistrojë në vazhdimësi edhe këtë gabim.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të bëjë reflektimin e këtij gabimi në të dhënat e regjistruara në serverin e raportimeve të shitjeve në DPT duke e stornuar atë (nëpërmjet pasqyrimit në një kolonë të veçantë). Pas zbritjes së gabimit (stornimit), subjekti do të vazhdojë raportimin e shitjeve, të cilat do të mbartin në vazhdimësi gabimin, por nga stornimi i bërë nga DPT shifra e raportuar do të korrigjohet për të treguar xhiron reale.

Mosnjoftimi i gabimit në regjistrim është përgjegjësi e tatimpaguesit dhe konsiderohet shitje nga ana e tij.

15.3 Procedurat e kthimit të një malli me defekt apo me kushte cilësore të papranueshme për klientin

Procedura e kthimit të mallrave të shitura nëpërmjet pajisjeve fiskale për arsye garancie apo kushtesh të papranueshme cilësore do të jetë si më poshtë:

Kur klientë të ndryshëm bëjnë kthimin e mallrave të shitura nëpërmjet pajisjeve fiskale (me arkëtim nga arkëtarja të pagesave cash), këta të fundit do të bëjnë hyrje të shoqëria mallin e kthyer (në ambientin ku është shitur ai), kundrejt mbajtjes së një procesverbali (modeli bashkëngjitur) dhe do të tërheqin paratë e blerjes nga shoqëria me mandatpagesë.

Subjekti tatimpagues do të bëjë hyrje në magazinë mallin e kthyer. Klienti blerës pas këtij procesi mund të blejë një mall tjetër të ri, apo mund të mos blejë një të tillë.

Vlefta e regjistruar nga pajisja fiskale, e mallrave të kthyera nga klientët si më lart, duhet të stornohet në librin e shitjeve të shoqërisë dhe shoqëria duhet ta reflektojë atë storno në librin e shitjeve mujore dhe me një njoftim pranë drejtorisë tatimore rajonale duhet të raportojë vlerën e mallrave të kthyera sipas modelit të njoftimit bashkëngjitur.

Procedura e stornimit të vlerës së mallrave të kthyera, të cilat domosdoshmërisht që të kthehen duhet të kenë bashkëngjitur edhe kuponin e shitjes, i cili i bashkëngjitet procesverbalit, reflektohet edhe në librin e shitjes (si stornim shitje).

15.4 Procedura e shitjes dhe e lëvizjes së karburanteve nga magazinat doganore dhe tatimore

15.4.1 Procedura e tregtimit të karburanteve (nga shoqëritë sh.a.) të subjektet e tregtimit me pakicë (sh.p.k.)

a) Tregtimi i karburanteve nga magazina doganore në pikat e tregtimit me pakicë do të kryhet në çdo rast nëpërmjet lëshimit të faturës tatimore, e cila shoqëron sasinë e karburantit të shitur. Sasia e karburantit që del nga magazina evidentohet nëpërmjet kalimatësave, të cilët kontrollohen periodikisht nga DPM. Në momentin e daljes nga magazina doganore, sasia e karburantit të shitur, përveç faturës tatimore, shoqërohet detyrimisht edhe me kuponin tatimor, i cili lëshohet nga pajisja fiskale. Kuponi i bashkëngjitet faturës tatimore për çdo dalje të karburantit (shitje të tij) dhe e shoqëron faturën tatimore gjatë të gjithë lëvizjes (transportit) nga pika e daljes nga magazina doganore/pika e shitjes me shumicë, deri në vendin e shkarkimit të karburantit në depozitat e subjektit blerës. Ai mbahet i tillë i bashkëngjitur me faturën tatimore nga blerësi.

Kuponi tatimor, i cili do t'i bashkëngjitet faturës tatimore të shitjes, duhet të përmbajë detyrimisht të regjistruar të gjitha të dhënat e kërkuara nga ky udhëzim por domosdoshmërisht të ketë referencën e faturës së lëshuar.

Subjektet e shitjes së karburantit nga magazina doganore (pika të shitjes me shumicë), janë të detyruara të raportojnë çdo ditë, me mbylljen e raportit tatimor ditor në pajisjen fiskale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përputhje me këtë udhëzim.

Doganieri kontrollon në daljen e magazinës nëse kuponi tatimor i është bashkëngjitur faturës tatimore dhe nuk lejon daljen e karburantit nga magazina doganore pa u lëshuar (prerë) kuponi tatimor nga pajisja fiskale e instaluar te kalimatësi.

Subjektet transportuese të karburantit, pas daljes nga magazina doganore, qofshin këto thjesht subjekte transportuese, në pronësi të subjektit blerës apo shitës, apo vetëtransportuese, detyrohen të mbajnë të bashkëngjitur me faturën tatimore edhe kuponin tatimor që i përket blerjes së karburantit që po transportohet. Mosparaqitja e këtij të fundit së bashku me faturën në një kontroll të mundshëm, i penalizon ato sikurse moslëshimi i faturës, bazuar në nenin 21 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Çdo lëvizje e karburantit pa lëshimin e kuponit tatimor krahas faturës tatimore, ngarkon me përgjegjësi ligjore dhe penaltete tatimore subjektin shitës me shumicë, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi administrative, sipas kuadrit ligjor në fuqi, punonjësën e doganës në vendin e daljes së karburantit nga magazina doganore, nëse ai nuk kontrollon lëshimin e kuponit tatimor.

Procedurat e pajisjes me dokumentacionin e përcaktuar më lart, për rastet e daljeve nga magazinat doganore, detyrohen të zbatohen edhe nga shoqëria "ARMO" sh.a. për daljet e karburanteve nga magazina tatimore.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet strukturave të tyre, kryejnë kontrole të vazhdueshme e të përbashkëta për zbatimin me korrektësi të këtij udhëzimi. Për zbatimin me korrektësi të këtij udhëzimi, ato vënë në dijeni subjektet që disponojnë magazina doganore për karburantin, dhe subjektin "ARMO", si dhe udhëzojnë punonjësit që ngarkohen me kontrollin e zbatimit të detyrave që dalin nga ky udhëzim.

b) Prej magazinës tatimore të shoqërisë (sh.a.) për në subjektet e tregtimit me pakicë (sh.p.k.) realizohet nëpërmjet faturës tatimore të shoqëruar me kupon tatimor të lëshuar nga pajisja fiskale e instaluar tek kalimatësi i magazinës së shoqërisë, i cili ka evidentuar edhe numrin e faturës tatimore sikurse u shpjegua më lart.

Subjektet transportuese të karburantit, pas daljes nga magazina tatimore, qofshin këto thjesht subjekte transportuese, në pronësi të subjektit blerës apo shitës, apo vetëtransportuese, detyrohen të mbajnë të bashkëngjitur me faturën tatimore edhe kuponin tatimor që i përket karburantit të shitur që po transportohet. Mosparaqitja e këtij të fundit, së bashku me faturën në një kontroll të mundshëm, i penalizon ato sikurse moslëshimi i faturës, bazuar në nenin 21 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Në këtë rast zbatohen të njëjtat penalitete sikurse në rastin e mësipërm të tregtimit të karburanteve nga magazinat doganore tek pikat e tregtimit me pakicë për vetë shoqërinë dhe transportuesin.

15.4.2 Procedura e lëvizjes së karburanteve nga magazina doganore e shoqërive të tregtimit me shumicë (sh.a.) tek magazinat tatimore pronë e tyre do të administrohet si më poshtë:

Karburanti del nga magazina doganore me fature shoqërimi sipas standardit të miratuar nga DPT, së cilës i bashkëngjitet detyrimisht kuponi tatimor i pajisjes fiskale për sasinë e nxjerrë nga kalimatësi, por domosdoshmërisht të ketë referencën e faturës së shoqërimit të lëshuar. Me hyrjen e karburantit në magazinën e shoqërisë, fatura e shoqërimit, së bashku me kuponin tatimor i bashkëngjitet fletëhyrjes së magazinës së shoqërisë. Kjo lëvizje nuk konsiderohet shitje nga ana e shoqërisë së tregtimit me shumicë (sh.a.) pasi ajo është një lëvizje e brendshme e saj dhe për këtë arsye vlera e kuponit tatimor që shoqëroi faturën e shoqërimit nuk do të raportohet si shitje në raportin ditor të shitjeve të shoqërisë (pra nga shitjet gjithsej ky kupon do të zbritet).

Edhe në këtë rast, zbatohen të njëjtat penalitete sikurse në rastin e mësipërm të tregtimit të karburanteve nga magazinat doganore tek pikat e tregtimit me pakicë në rastet e shkeljeve të procedurës së pajisjes me dokumentacionin e kërkuar, për vetë shoqërinë, transportuesin dhe punonjësën e doganës.

15.5 Procedura e importimit të karburanteve nga shoqëritë (sh.a.) nëpërmjet transportit me mjete tokësore (autobote), zhdoganimi i të cilave bëhet nëpërmjet pikave të kalimit kufitar tokësor

Nëse importimi i karburanteve dhe i gazit kryhet nga ana e shoqërive sh.a. nëpërmjet autoboteve të cilat kryejnë zhdoganimin në pikën e kalimit kufitar tokësor, këto automjete, për të shitur direkt tek pikat e shitjeve me pakicë sh.p.k. (kur nuk bëhet shkarkimi në magazinën tatimore) duhet detyrimisht të kenë të instaluar kalimatësin me pajisjen fiskale për të tregtuar direkt tek këto shoqëri (sh.p.k.) si në rastin e magazinave doganore, duke lëshuar bashkëngjitur kuponit tatimor edhe faturën tatimore.

Nëse automjeti (autoboti) i karburantit nuk ka të instaluar kalimatën dhe pajisjen fiskale, ai detyrimisht duhet të bëjë shkarkimin në magazinën e tij tatimore.

15.6 Procedura e trajtimit të lëvizjes së karburanteve nga një rezervuar i shoqërisë tek një tjetër (pa ndryshim të pronësisë)

Në rastet kur për nevoja lëvizjeje të produkteve të karburanteve të ndryshme pronë e një subjekti tatimpagues nga një rezervuar në një tjetër brenda shoqërisë, apo për nevoja provash, meqenëse pajisjet fiskale janë projektuar të mos lejojnë nxjerrjen e mallit (karburantit) pa kupon tatimor, kjo dalje e tij nga rezervuarët do të konsiderohet shitje (përderisa do të shoqërohet me kupon tatimor), por do të ndiqet kjo procedure pune:

Së bashku me nxjerrjen e sasisë së karburantit i cili shoqërohet me nxjerrjen e kuponit tatimor, shoqëria poseduese e karburantit do të presë një faturë tatimore (me TVSH), do ta bashkëngjisë atë me kuponin tatimor përkatës dhe do ta regjistrojë si shitje në librin e shitjeve të shoqërisë, duke evidentuar në faturë destinacionin e vendndodhjes së depozitës ku ajo po e adreson këtë sasi karburanti.

Pas zbrazjes së kësaj sasi karburanti në depozitën tjetër (pronë e shoqërisë), do të bëhet regjistrimi në blerje me faturën e blerjes (me TVSH) me të njëjtin çmim dhe sasi. Ky veprim do të rezultojë pa efekte për shoqërinë.

Problemi i reflektimit të këtij veprimi në shitjet e karburantit nga ana e shoqërisë nëpërmjet pajisjes fiskale të pompës në nxjerrjen e karburantit kërkon të stornohet nga subjekti i cili tashmë e ka regjistruar një veprim të tillë si shitje. Kjo bëhet duke vënë në dijeni organin tatimor me njoftim (modeli bashkëngjitur) për sasinë e nxjerrë për këtë qëllim nga ana e shoqërisë. Sapo veprimi i mësipërm është kryer, subjekti regjistron në librin e shitjeve

sasinë e nxjerrë prej tij edhe në librin e blerjeve, po këtë sasi të bërë hyrje në librin e blerjeve. Nga ky veprim efekti për shoqërinë mbetet zero (janë reflektuar në shitje dhe në blerje të njëjtat karburante në sasi e në vlerë). Pas kësaj, subjekti stornon (zbret) vetëm vlerën që ka regjistruar pajisja fiskale në kohën e nxjerrjes së kësaj sasive karburanti, e cila në fakt nuk është shitur. Këtë stornim ai nuk e reflekton në librin e shitjeve por vetë në deklarimet e shitjeve nëpërmjet pajisjeve fiskale duke njoftuar organin tatimor për të kryer rregullimet e shitjeve nëpërmjet pajisjeve fiskale në serverin e DPT-së e cila e reflekton këtë veprim.

15.7 Procedura e shitjes së karburantit me tollona nga shoqëritë e licencuara të karburanteve

Shitja me tollona e karburantit, nga distributorët e shitjes me pakicë (nga shoqëritë e licencuara në këtë lloj aktiviteti biznesi), do të ndjekë këtë procedurë:

Tollonat e shpërndara institucioneve të ndryshme apo shoqërive tregtare, të cilat kanë lidhur një kontratë me shoqërinë e shitjes së karburanteve do të jepen së bashku me lëshimin e faturës tatimore që ato përfaqësojnë.

Tollonat e shpërndara nga shoqëritë e karburanteve do të mblidhen nga secila pikë shitje e karburanteve nga punonjësi i pikës dhe do t'i bashkëngjiten kuponit të nxjerrë në momentin e furnizimit i cili evidenton: "shitje me tollona".

Çmimet e llojeve të produkteve të karburanteve në momentin e furnizimit (nxjerrjes nga rezervuari dhe lëshimit të kuponit tatimor të pompës) nuk do të ndryshojnë nga ato të shitjeve ditore.

Vlera e faturës për dhënien e tollonave të lëshuara nga shoqëria e tregtimit të karburanteve do arkëtohet vetëm nëpërmjet kalimit nga sistemi bankar. Kjo shumë do të raportohet në FDP-në e muajit të lëshimit të faturës.

Vlera ditore e kuponëve të shoqëruar me tollonat përkatës, do të stornohet nga shitjet ditore gjithsej nëpërmjet pompës tek libri raporteve ditore, kjo pasi ato janë pjesë e raportuar më parë nëpërmjet faturës tatimore të lëshuar në momentin e furnizimit me tollona.

15.8 Procedura e shitjeve me automate (*vending machine*)

Lëndët e para, të cilat dalin nga magazina e shoqërisë tuaj për furnizimin e makinetave (*vending machine*) duhet të lëvizin me faturë shoqëruese tatimore të shpërndarë nga drejtoria rajonale tatimore ku është regjistruar shoqëria juaj me çmimet e magazinës nga e cilat ato do të dalin dhe me përcaktimin e qartë të destinacionit për të cilin po lëvizin për furnizim.

Në rastet e sasive të kthyera (për arsye të ndryshme) bëhet hyrje e lëndëve të para në magazinën e shoqërisë po me çmimin e daljes së tyre nga magazina duke evidentuar sasinë e kthyer e cila bëhet përsëri hyrje në magazinë.

Në momentin e furnizimit të makinetës (*vending machine*) për sasinë e furnizuar të mallit të specifikuar e të adresuar për secilën makinetë (për të cilën arkëtohen para *cash* pritët një kupon tatimor nëpërmjet kasës regjistruese të lëvizshme e cila mbahet në makinën transportuese me çmimet e reklamuar në makinetë për çdo artikull që makinetat jepen furnizim të produktit (furnizon), për të cilën arkëtohet kundravlefata në para *cash*. Kështu veprohet për çdo rast furnizimi në çdo makinetë.

Në këtë mënyrë, pajisja fiskale ka evidentuar të gjitha arkëtimet e kryera që i përkasin një furnizimi të nevojshëm nga konsumi i llojeve të artikujve për të cilat janë arkëtuar para *cash* nga përdoruesit (klientët blerës).

Në lidhje me NIPT-et e makinetave kërkohet që secila kontratë e lidhur me një institucion të caktuar (nëpërmjet kontratës në të cilën janë evidentuar numri, lloji, numri serial i makinetës dhe vendosja e saj) hapet një NIPT sekondar. Një NIPT i tillë sekondar hapet për çdo kontratë me institucionin ku është rënë dakord të vendosen makinetat.

15.9 Procedurat e raportimit të shitjeve ditore nëpërmjet pajisjeve fiskale të shoqërisë apo të personit fizik

Në përfundim të orarit të punës çdo tatimpagues, pasi ka mbyllur shitjet ditore, duhet t'i raportojë ato *on-line* në serverin e DPT-së, por ky raportim nuk duhet të kalojë orarin më të fundit të pranueshëm ora 24.00, pas të cilit fillon një datë e re.

Fillimi i raportimit të shitjeve ditore pas disa ditë ndërprerjesh për arsye të ndryshme kryhet ditën e parë të fillimit të përdorimit të pajisjes fiskale.

16. Moslejimi i përdorimit të printerave jofiskale në pikën e shitjes

Tatimpaguesit të cilët detyrohen sipas legjislacionit fiskal të përdorin pajisjet fiskale iu ndalohet të mbajnë dhe përdorin në pikën e shitjes printera të tjerë jofiskalë për qëllime lëshimi kuponësh. Për raste kur nga ana e inspektorit tatimor do të konstatohen se tatimpaguesi mban edhe printer jo fiskal në pikën e shitjes, nëpërmjet të cilit mund të nxjerrë kupon për shitje, apo evidentohet se nxjerr krahas kuponit tatimor edhe kupon jotatimor, ndaj atij tatimpaguesi zbatohen penalitetet e përcaktuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 122, pika 1, germa “c”.

17. Pajisjet shtesë

Një pajisje fiskale mund të ketë pajisje shtesë, të tilla si: bar-kod, skaner, peshore, terminal për pagesën, nëpërmjet kartave të kreditit, dhe një printer. Lidhja e pajisjeve shtesë mund të realizohet ekskluzivisht nëpërmjet një ndërfaqeje (ndërlidhje) kontrolli të pajisjes fiskale.

Terminal të integruar apo të jashtëm për pagesën me kartë krediti duhet të:

a) jetë në përputhje me standardin ISO (8583, 9564, etj.)

b) standardet EMV 3.1.1

c) specifikimin VISA ICC Terminal Specification V.1.2.3.)

d) kërkesat minimale të “EUROPAY” (EUROPAY minimal terminal requirements 2.1.)

18. Administrimi i procesit dhe dokumentacionit të pajisjeve fiskale nga drejtoritë rajonale tatimore

18.1 Administrata tatimore është organi përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin e procesit të instalimit dhe përdorimit të pajisjeve fiskale, për qëllimet e matjes së volumit të shitjes së mallrave e shërbimeve të realizuara nga tatimpaguesit.

18.2 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe drejtoritë rajonale tatimore janë koordinatorë dhe kontrollues të ecurisë së procesit të implementimit të pajisjeve me memorie fiskale dhe administrojnë procesin e implementimit në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionit për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale”, të ndryshuar.

18.3 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe drejtoritë rajonale nën vartësinë e saj, krijojnë strukturat e nevojshme për administrimin dhe kontrollin e implementimit të procesit për instalimin e pajisjeve fiskale. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve krijohet sektori i pajisjeve fiskale brenda Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit, e cila menaxhon procesin e krijimit dhe funksionimit të sistemit të integruar për transferimin periodik, automatik të deklarimeve financiare. Në drejtoritë rajonale tatimore ngrihen njësitë e administrimit të dosjeve të pajisjeve fiskale për çdo tatimpagues përdorues.

18.4 Strukturat e ngritura pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe drejtorive rajonale për administrimin e procesit, mbajnë të sistemuar gjithë dokumentacionin që i përket procesit të implementimit të pajisjeve fiskale në dosjet përkatëse të çdo tatimpaguesi. Ato bëjnë kujdes për mbështetjen e tatimpaguesve me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kohë dhe ofrojnë ndaj tatimpaguesve mbështetjen e nevojshme ligjore dhe procedurale për

realizimin me sukses të procesit.

18.5 Organet tatimore organizojnë në mënyrë të programuar punën për implementimin e pajisjeve fiskale në vartësi të prioritetëve të Qeverisë bazuar në vendimet e Këshillit të Ministrave dhe realizojnë një proces transparent, të drejtë e të barabartë kontrolli dhe verifikimi, për të gjithë tatimpaguesit, në instalimin, përdorimin dhe kontrollin e pajisjeve fiskale.

“- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i krijon çdo njësie të qeverisjes vendore, bashkie apo komune, mundësinë e aksesit në të dhënat e deklarimeve financiare të pajisjes fiskale për bizneset të cilat janë në administrim nga organet e qeverisjes vendore (biznes i vogël) sipas juridiksionit respektiv, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim nga ana e tyre”.

18.6 Inspektorët tatimorë, të ngarkuar me detyrën për administrimin dhe kontrollin e përdorimit të pajisjeve fiskale, në punën e tyre mbështesin plotësimin e kërkesave ligjore, akteve nënligjore dhe kërkesave të rregulloreve për këtë qëllim. Ata krijojnë kushtet normale që tatimpaguesit të kryejnë pa pengesa për ndërprerje aktivitetin e biznesit.

18.7 Inspektorët tatimorë trajnohen në mënyrë të vazhdueshme për njohjen sa më mirë të kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007, të ndryshuar, akteve të tjera nënligjore si dhe të kërkesave të këtij udhëzimi.

18.8 Inspektorët tatimorë në punën e vazhdueshme për implementimin e sistemit të pajisjeve fiskale dhe funksionimit normal të tyre, krijojnë një bazë të dhënash që shërben për njohjen e situatës në terren, duke fokusuar vëmendjen në mënjanimin e rrezikut të shmangies ndaj realizimit të detyrës.

18.9 Inspektorët tatimorë bëjnë përpjekje për njohjen e mirë të të gjithë dokumentacionit të miratuar, dokumentacioni i cili i bashkëngjitet këtij udhëzimi, dhe kërkojnë zbatimin rigoroz të procedurave për regjistrimin fillestar të pajisjeve fiskale, kontrollin e plotësimit të dokumentacionit, arkivimin e tij në dosjen e tatimpaguesit etj. Inspektorët tatimorë të ngarkuar me këtë detyrë kontrollojnë procesin e përdorimit korrekt të pajisjeve fiskale dhe mbajnë qëndrim ligjor ku vërejnë shkelje ndaj moslëshimit të kuponit tatimor nëpërmjet pajisjeve fiskale.

18.10 Inspektorët tatimorë ndihmojnë në kapërcimin e vështirësive që iu krijojnë tatimpaguesve në rastet kur pajisjet fiskale nuk funksionojnë dhe mbështesin tatimpaguesit nëpërmjet ndërhyrjes së tyre jo vetëm për eliminimin sa më parë të defekteve të pajisjeve fiskale, por edhe për mbështetjen me dokumentacionin e përcaktuar në këto raste. Ata kontrollojnë me shpejtësi e saktësi plotësimin nga tatimpaguesit të formularëve përkatës dhe kërkojnë vazhdimin pa ndërprerje të procesit të lëshimit të faturave nga tatimpaguesit duke kryer në vend kontrole, por duke bashkëpunuar edhe me subjektet furnizuese të pajisjeve fiskale për mënjanimin sa më parë të defekteve.

18.11 Organet tatimore marrin masa të vazhdueshme për trajnimin e tatimpaguesve për njohjen sa më mirë të pajisjeve fiskale, të legjislacionit detyrues për përdorimin e tyre, por edhe për masat që zbatohen në rastet e ndërprerjes së funksionit të pajisjeve fiskale për shkaqe të ndryshme. Ato punojnë në frymën e bashkëpunimit me tatimpaguesit për të shmangur keqkuptimet dhe për kuptimin e zbatimit korrekt të kërkesave ligjore.

18.12 Organet tatimore mbajnë në mënyrë të vazhdueshme kontakte me shoqëritë e licencuara nga Ministri i Financave për furnizimin e tatimpaguesve me pajisje fiskale dhe ndërhyjnë kurdoherë kur vërejnë neglizhenca nga ana e këtyre të fundit, neglizhenca të cilat dëmtojnë procesin dhe devijojnë nga detyrimet kontraktuale që kanë këto shoqëri, detyrime të cilat janë pjesë e licencimit.

18.13 Organi tatimor kontrollon furnizimin e tatimpaguesve me pajisje fiskale që ai të jetë sipas karakteristikave teknike të përcaktuara në VKM, në raste të veçanta kërkon bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për këtë qëllim.

18.14 Fiskalizimi i pajisjeve fiskale kryhet në ambientet e shoqërive të licencuara (me përjashtim të pikave të karburanteve, për të cilat fiskalizimi kryhet në ambientet e pikës së karburanit) pas nënshkrimit të kontratës nga tatimpaguesit me këto shoqëri, pasi të jetë plotësuar saktë formulari për furnizimin me pajisje, kontrolli i saktësisë së të dhënave të plotësuara të formularit dhe vetëm pas këtij kontrolli kryhet fiskalizimi i pajisjes fiskale nëpërmjet nënshkrimit të formularit nga inspektori tatimor, shoqëria e licencuar dhe tatimpaguesi duke administruar edhe kopje të kontratës së lidhur ndërmjet tyre. Shoqëritë e autorizuar, përveç kopjeve në letër të dokumentacionit përkatës, duhet t'i dërgojnë të dhënat e formularëve të përdorur edhe në format elektronik. Të dhënat elektronike dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatime. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është përgjegjëse për mirëmbajtjen e formularëve që do të përdoren në procesin e implementimit të pajisjeve fiskale në Republikën e Shqipërisë dhe është e detyruar që të gjithë formularët (së bashku me sqarimet për plotësimin e tyre) t'i publikojë në format elektronik në faqen e saj të internetit.

18.15 Inspektori tatimor i ngarkuar me kontrollin e pajisjeve fiskale dhe lëshimin e kuponëve tatimorë kërkon që në ambientet ku funksionon pajisja fiskale të evidentohet e shkruar qartë për klientet detyrimi i tyre për tërheqjen e kuponit tatimor dhe ndëshkimi i tyre sipas ligjit për mostërheqje të kuponit.

18.16 Inspektorët tatimorë kryejnë rregullisht kontrolle për lëshimin e kuponëve tatimorë dhe mbajnë procesverbale kur konstatojnë shkelje duke vendosur në vend gjobën sipas përcaktimeve ligjore, për tatimpaguesit dhe për klientët shkelës të ligjit.

18.17 Organi tatimor sensibilizon opinionin publik në lidhje me domosdoshmërinë e marrjes së kuponit tatimor dhe masat ndëshkimore edhe për ta, në rastet e mosmarrjes së faturës. Organet tatimore emetojnë dhe shpërndajnë falas broshura e fletëpalosje për këtë qëllim, si dhe organizojnë biseda me grupe të komunitetit të biznesit, në televizion e masmedia. Ata propagandojnë raste të shkeljeve dhe masat ndëshkimore të marra ndaj tatimpaguesve të ndryshëm, sikurse evidentojnë edhe rastet pozitive të zbatimit të kësaj reforme.

19. Përdorimi i dëftësave tatimore në rastet e mosfunksionimit të përkohshëm të pajisjeve fiskale

Në rastet e mosfunksionimit të përkohshëm të pajisjeve fiskale, të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, tatimpaguesit janë të detyruar të përdorin dëftesën tatimore për çdo shitje me pakicë që realizojnë. Blloku me dëftesa tatimore do të furnizohet nga drejtoritë rajonale tatimore dhe do të jetë me numër seria (modeli bashkëngjitur udhëzimit).

Mbas riparimit të pajisjes fiskale, tatimpaguesi fillon menjëherë përdorimin e saj.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përcakton procedurat dhe dokumentacionin që do të mbajnë sektorë të veçantë të biznesit për përdorimin e pajisjeve fiskale duke marrë parasysh specifikat që përfaqësojnë këta sektorë. Për këtë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon procedurat për këto raste në faqen e saj të internetit.

Bashkëngjitur këtij udhëzimi modelet e dëftësës tatimore, procesverbali i kthimit të mallrave, modeli i raportit ditor.

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr.39, datë 9.12.2008, udhëzimi nr.38, datë 1.9.2009 dhe udhëzimi nr.43, datë 30.10.2009, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

DĚFTESĚ TATIMORE

Subjekti _____
NIPT-i _____
Adresa _____

[illegible]

Bleresi

()

Dëftesa Tatimore prodhohet nga Drejtoria e Përgjithshme Tatimore në numra serial me 7 shifra nga dy kopje të të njëjtit numur serial me letër vetëkoppjuesë dhe me ngjyrë të ndryshme, nga të cilat njëra (kopja e parë me ngjyrë të bardhë) i jepet klientit dhe kopja e dytë me ngjyrë të verdhë mbetet në bllokun e tatimpaguesit dhe shërben për përlogaritjen e xhirros së realizuar nëpërmjet lëshimit të Dëftesës Tatimore (në mungesë të pajisjes fiskale si dhe për efektë kontrolli nga ana e organeve tatimore). Shuma e shitjeve të realizuara nëpërmjet lëshimit të Dëftesës Tatimore i shtohet shitjeve të realizuara nëpërmjet pajisjes fiskale të asaj pike shitjeje dhe përbën shitjet mujore të asaj pike. Për rastet e përdorimit të Dëftesës tatimore nga ana e tatimpaguesve që nuk janë subjekte të TVSH-së kjo Dëftesë Tatimore do të plotësohet deri tek kollona Vlera.

Shënim Teknik : Përmbajtja e shënimeve do të printohet nga faqja e mbrapme e Dëftesës Tatimore

RAPORTI DITOR I SHITJEVE ME PAJISJE FISKALE PER MUAJIN _____
(PER SUBJEKTET ME TVSH)

Data	Shitje me fature tatimore me TVSH (e shqyrtuar me kupon tatimor)				Shitje me kupon tatimor				Shitje me deftese tatimore (Vetem kur eshte detyruar pajisja)				Shitjet gjithesej				Shuma e regjistruar gabimisht me pajisje fisk.	Shuma qe lexon pajisja fiskale ne fund te dites (shifra) n
	Vlera e tatueshme (ne lekë) A	Vlera TVSH-së (ne lekë) b	Vlera me TVSH (ne lekë) c	Vlera e tatueshme (ne lekë) d	Vlera TVSH-së (ne lekë) e	Vlera me TVSH (ne lekë) f	Vlera e tatueshme (ne lekë) g	Vlera TVSH-së (ne lekë) h	Vlera me TVSH (ne lekë) i	Totali vlerës tatueshme (ne lekë) j=(a+d+g)	Totali vlerës TVSH-së (ne lekë) k=(b+e+h)	Totali vlerës me TVSH (ne lekë) l=(f+i+l)						
1																		
2																		
3																		
4																		
5																		
6																		
7																		
8																		
9																		
10																		
11																		
12																		
13																		
14																		
15																		
16																		
17																		
18																		
19																		
20																		
21																		
22																		
23																		
24																		
25																		
26																		
27																		
28																		
29																		
30																		
31																		
	SHUMA																	

Shenim : Ky raport ditor mbahet nga tatimpaguesi çdo dite ne perfundim te aktivitetit te shijeve. Te dhënat e regjistruara ne kete raport per tatimpaguesit me TVSH hidhen ne librat e shijeve mujore te shqerise . Per rastin e shijeve me kupon tatimor te shqeruar edhe me Fature Tatimore do te regjistrohet Nr serial i fatures dhe vlera e shijes por nuk do te mbledhet me shumen e shijeve vetem me fature tatimore (qe pagesa eshte bere me bankë). Ne raportimin e FDP-se pra do te jepet shuma : me Fature Tatimore plus ajo fatura e shqeruar me kupon tatimor dhe ajo vetem me kupon tatimor (ajo per te mos dubluar raportimin e shijeve.

Model 2

Nr. Pajisjes Fiskale _____
Vendndodhje _____

RAPORTI DITOR I SHITJEVE ME PAJISJE FISKALE PER MUAJIN _____
PER SUBJEKTET E BIZNESIT TE VOGEL PA TVSH

PER SUBJENTET E DIZJENIT TE VOULETA TVSH

Data	Shitje me kupon tatimor				Shitje me deftese tatimore (Vetem kur eshte demtuar pajisja)			Shuma e regjis- truar gabimisht ne pajisje fisk. (në lekë) m	Shuma qe lexon pajisja fiskale ne fund të ditës (shifra) n
	Shitje me kupon tatimor		Shitje me deftese tatimore (Vetem kur eshte demtuar pajisja)						
	Vlera e tatueshme (në lekë) d	Vlera TVSH-së (në lekë) e	Vlera me TVSH (në lekë) f=d	Vlera e tatueshme (në lekë) g	Vlera TVSH-së (në lekë) h	Vlera me TVSH (në lekë) i=g			
1		0			0				
2		0			0				
3		0			0				
4		0			0				
5		0			0				
6		0			0				
7		0			0				
8		0			0				
9		0			0				
10		0			0				
11		0			0				
12		0			0				
	Shuma								

Nr. Rend _____

PROCES -VERBAL
MBI KTHIMIN E MALLIT TE SHITUR ME KUPON TATIMOR

Sot në datë ____ 20 __, ora ____ në subjektin _____ me NIPT ____ me njësi shitje me pakicë të mallrave/shërbimeve në njësinë me Adresë : Rr. _____, Nr. _____, Qyteti _____, nga klienti : (Emri) _____, (Mbiemri) _____, me nr, pasportë _____, u kthye malli i shitura nga kjo njësi shitje në datën _____ arsyjeja) _____.

Malli i kthyer (bashkangjitur kuponi tatimor) ishte sipas përshkrimit sa vijon:

Nr. Rend.	Emërtimi i mallit	Kodi i mallit	Sasia copë	Çmimi lekë pa TVSH	Vlera e llog. e TVSH-së	Çmimi me TVSH

Nr. Serial i faturës tatimore _____, Nr.Rendor i faturës, data _____

Subjekti shitës
(Emër Mbiemër, Firmë)

Klienti
(Emër Mbiemër, Firmë)

Shënim:

1. Ky Proces-Verbal shoqërohet me Mandat-Pagesën Nr. _____, datë _____ në shumën _____ lekë dhe kuponin tatimore të lëshuar nga pajisja fiskale për mallrat e kthyer në këtë vlerë. Pa shoqërimin me kuponin tatimor përkatës nuk lejohet kthimi i mallrave nga klienti dhe nuk kthehet shuma e lekëve nëpërmjet Mandat-Pagesës.
2. Shoqëria shitëse e mallit e prodhon vetë këtë model Proces-Verbal dhe ja paraqit atë organeve të kontrollit në çdo rast që kërkohet prej tyre.
- 3.Nr. Rendor i proces-verbaleve (në dy kopje të njëjta me letër vetëkopjuese) duhet të jetë progresiv.
4. Nëse malli kthehet nga një subjekt tatimagues në proces- verbal do të shënohet edhe nr. seriali i faturës tatimore, numri rendor i saj dhe data e lëshimit, fotokopje e së cilës i bashkangjitet proces-verbalit përkatës të saj.

Shënim: Ky proces-verbal mbahet në dy kopje të njëjta nga të cilat kopja e parë (originale) i jepet klientit dhe kopja e dytë mbahet nga subjekti shitës.